

Deri te:

**KËSHILLI MËSIMOR-SHKENCOR I  
FAKULTETIT TË SHKENCAVE MJEKËSORE  
UNIVERSITETI I TETOVËS**

**R E F E R A T**

PËR ZGJEDHJEN E NJË MËSIMDHËNËSI NË TË GJITHA THIRRJET MËSIMORE-  
SHKENCORE NË LËNDËT: HIGJENË, KUJDES SHËNDETËSOR DHE EDUKIM  
SHËNDETËSOR ME METODOLOGJI, NË FAKULTETIN E SHKENCAVE MJEKËSORE  
NË UNIVERSITETIN E TETOVËS

Me vendim të Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit të Shkencave Mjekësore të Universitetit të Tetovës me nr. arkivi 22-3920/1 të datës 14.12.2021, dhe në bazë të konkursit të shpallur më: 25.12.2021 në gazetën ditore “Koha” dhe “Sloboden Peçat”, është caktuar komisioni recensues me nr. arkivi 22-171/1 të datës 03.02.2022, për zgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët mësimore në fushën e Kujdesit shëndetësor - Infermieri (305), respektivisht në lëndët: **Higjienë, Kujdes shëndetësor, Edukim shëndetësor me metodologji** (30500, 30501, 30502 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë - hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në përbërje me:

1. **Prof.Dr. Sadi Bexheti (kryetar)**, profesor ordinar në Fakultetin e Shkencave Mjekësore, Universiteti i Tetovës, Tetovë.
2. **Prof.Dr. Lutfi Zylbeari (anëtar)**, profesor ordinar në Fakultetin e Shkencave Mjekësore, Universiteti i Tetovës, Tetovë.
3. **Doc.Dr. Muhamed Tairi (anëtar)**, docent në Fakultetin e Shkencave Mjekësore, Universiteti i Tetovës, Tetovë.

Komisioni i lartpërmendur pasi që i pranoi materialet e dorëzuara në konkurs, titullit të lartpërmendur i paraqet këtë:

**RAPORT**

Me datë 25.12.2021 në gazetën ditore “Koha” dhe “Sloboden Peçat” është shpallur konkurs për zgjedhje të një mësimdhënësi në Fakultetin e Shkencave Mjekësore për lëndët mësimore në fushën e Kujdesit shëndetësor - Infermieri, respektivisht në lëndët: **Higjienë, Kujdes shëndetësor, Edukim shëndetësor me metodologji**.

Komisioni në fjalë, pasi kontrolloi materialet e dorëzuara, konstatoi se në konkurs është paraqitur një kandidat, edhe atë:

1. **Dr.sc Veton Ademi**

## **TË DHËNAT BIOGRAFIKE DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL**

Veton Ademi është i lindur më 24.03.1989 në Tetovë. Shkollën fillore e kreu në fshatin Shemshovë në vitin 2003, ndërsa arsimin e mesëm e mbaroi në vitin 2007 në SHMM “Nikolla Shtejn”-Tetovë, drejtimi i përgjithshëm. Kandidati studimet deridiplomike i ka përfunduar në Fakultetin e Shkencave Mjekësore pranë Universitetit të Tetovës, drejtimi: Infermieri e përgjithshme në vitin 2010.

Studimet e magjistraturës i ka përfunduar në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike të Universitetit të Mjekësisë në Tiranë, në programin studimor “Master i Shkencave në Menaxhimin Infermior”. Me datë 06.02.2013 me sukses ka mbrojtur temën “Incidenca e Diabetes Mellitus në Tetovë dhe rrethinë” dhe merr titullin: Magjistër i shkencave në Menaxhim Infermior.

Veton Ademi nga viti akademik 2013/2014 është i angazhuar si asistent në marrëdhënie jo të rregullt pune në Fakultetin e Shkencave Mjekësore të Universitetit të Tetovës.

Në Tetor të vitit akademik 2016/2017 i regjistron studimet e doktoraturës në Fakultetin e Shkencave Mjekësore të Universitetit të Tetovës, në programin studimor Biomedicinë. Ndërsa me datë 30.11.2021 me sukses e mbron tezën e disertacionit të doktoratës: “Karakteristikat antropometrike të fëmijëve dhe rinisë në rajonin e Pollogut” dhe merr titullin: Doktor i Shkencave nga fusha e shkencave Mjekësore - lëmia Biomedicinë.

Në Tetor të vitit akademik 2016/2017 emërohet: Përgjegjës i programit studimor: Fizioterapi, pozitë të cilën e ka mbajtur 1 vit, deri më Tetor të vitit akademik 2017/2018.

Në Tetor të vitit akademik 2017/2018 emërohet në pozitën e Koordinatorit për ECTS pranë Fakultetit të Shkencave Mjekësore në Universitetin e Tetovës, pozitë të cilën e ka mbajtur 4 vite, deri më Tetor të vitit akademik 2021/2022.

Në Maj të vitit 2019 zgjidhet asistent-bashkëpunëtor pranë Fakultetit të Shkencave Mjekësore në Universitetin e Tetovës.

## **VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE**

Dr. sc Veton Ademi në kuadër të veprimtarisë mësimore-arsimore pranë Fakultetit të Shkencave Mjekësore në Universitetin e Tetovës ligjeron lëndën Edukim shëndetësor, mban ushtrime në lëndët: Kujdes Mjekësor I, Kujdes Mjekësor II në programin studimor: Infermieri e përgjithshme dhe Akusheri.

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës, kandidati Veton Ademi ka realizuar gjithsej 43.92 pikë nga veprimtaria mësimore-arsimore.

## **VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE**

Krahas angazhimit në procesin mësimor, kandidati është marrë me hulumtime shkencore në fushën e shkencave të mjekësisë.

Veprimtaria shkencore-hulumtuese e kandidatit përbëhet nga artikuj shkencorë të botuar në revista shkencore ndërkombëtare, me pjesëmarrje në tubime shkencore.

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës, kandidati Dr.sc Veton Ademi ka realizuar gjithsej 48.6 pikë nga veprimtaria shkencore-hulumtuese.

## **VEPRIMTARIA PROFESIONALE - APLIKATIVE**

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës, kandidati Dr.sc Veton Ademi në këtë veprimtari ka grumbulluar 4 pikë.

## **VEPRIMTARIA NGA INTERESI MË I GJËRË**

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës, kandidati Dr.sc Veton Ademi në këtë veprimtari ka grumbulluar 13 pikë.

## **FORMULARI PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJE NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE**

Në shtojcat e mëposhtme është bashkangjitur formulari për raportin e zgjedhjes në thirrjen mësimore-shkencore. Kandidati Dr.sc Veton Ademi ka grumbulluar gjithsej 109.52 pikë, edhe atë për: veprimtarinë mësimore-arsimore 43.92, veprimtarinë shkencore-hulumtuese 48.6 pikë, veprimtarinë profesionale - aplikative 4 pikë dhe veprimtarinë me interes më të gjerë 13 pikë.

<b>REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJE</b>	<b>PIKË</b>
VEPRIMTARIA MËSIMORE-SHKENCORE	43.92
VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE	48.6
VEPRIMTARIA PROFESIONALE - APLIKATIVE	4
VEPRIMTARIA ME INTERES TË GJËRË	13
<b>GJITHSEJ</b>	<b>109.52</b>

## PËRFUNDIMI DHE PROPOZIMI

Në bazë të pasqyrës së prezantuar më lartë, si dhe nga të dhënat në shtojcë, Komisioni Recensues i vlerëson pozitivisht aktivitetet në veprimtaritë mësimore-arsimore, shkencore-hulumtuese dhe veprimtarinë me interes më të gjerë dhe konstaton se kandidati Dr.sc Veton Ademi në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore-mësimore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës, ka grumbulluar gjithsej 109.52 pikë nga referencat profesionale, me këtë e ka tejkaluar numrin minimal të pikëve që duhet të realizohen, për zgjedhjen në thirrjen mësimore-shkencore: **Docent**.

Komisioni recensues duke u bazuar në të dhënat e mësipërme për aktivitetin e përgjithshëm të kandidatit dhe në bazë të Ligjit për arsim të lartë të Republikës së Maqedonisë Veriore, në përputhje me Rregulloren për kriteret e veçanta për procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës, ka nderin dhe kënaqësinë t'i propozojë Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit të Shkencave Mjekësore në Universitetin e Tetovës, që kandidati **Dr.sci Veton Ademi** të zgjidhet në thirrjen mësimore shkencore **docent** për lëndët mësimore në fushën e **Kujdesit shëndetësor - Infermieri** (305), respektivisht në lëndët: **Higjienë, Kujdes shëndetësor, Edukim shëndetësor me metodologji** (30500, 30501, 30502 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë - hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).

**Shkurt 2022, Tetovë**

**Komisioni recensues:**

1. Prof.Dr. Sadi Bexheti (kryetar)

---

2. Prof.Dr. Lutfi Zylbeari (anëtar)

---

3. Doc.Dr. Muhamed Tairi (anëtar)

---

## S H T O J C Ë

### PËR RAPORTIN E ZGJEDHJES NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE

**Kandidati:** Veton Abdylbaki Ademi  
**Institucioni:** Fakulteti i Shkencave Mjekësore - Universiteti i Tetovës, Tetovë  
**Lëmia shkencore:** Kujdesi shëndetësor (Infermieri)

#### VEPRIMTARIA MËSIMORE - ARSIMORE

Nr.	Emri i aktivitetit	Kalkulimi	Pikët
<b>1</b>	<b>Mbajtja e ligjëratave dhe ushtrime në ciklin e parë të studimeve</b>		<b>30.6</b>
1.1	<b>Viti akademik 2019/2020- semestri dimëror</b>		
	Kujdes Mjekësor I (Infermieri)	12x15x0.03	5.4
1.2	<b>Viti akademik 2019/2020- semestri veror</b>		
	Kujdes Mjekësor II (Infermieri)	12x15x0.03	5.4
	Edukim shëndetësor (Akushi)	2x15x0.04	1.2
1.3	<b>Viti akademik 2020/2021- semestri dimëror</b>		
	Kujdes Mjekësor I (Infermieri)	12x15x0.03	5.4
1.4	<b>Viti akademik 2020/2021- semestri veror</b>		
	Kujdes Mjekësor II (Infermieri)	12x15x0.03	5.4
	Edukim shëndetësor (Infermieri)	2x15x0.04	1.2
	Edukim shëndetësor (Akushi)	2x15x0.04	1.2
1.5	<b>Viti akademik 2021/2022- semestri dimëror</b>		
	Kujdes shëndetësor I (Infermieri)	12x15x0.03	5.4
<b>2</b>	<b>Konsultime me studentë</b>		<b>1.52</b>
2.1	Kujdes Mjekësor I	80x3x0.002	0.48
2.2	Kujdes Mjekësor II	80x2x0.002	0.32
2.3	Edukim shëndetësor	120x3x0.002	0.72
<b>3</b>	<b>Anëtar komisioni për mbrojtjen e temës në ciklin e parë</b>	19x0.2	<b>3.8</b>
<b>4</b>	<b>Skriptë interne për ligjërime</b>		<b>8</b>
4.1	Muhamed Tairi, Veton Ademi. "Kujdesi shëndetësor" (Praktikum), Tetovë 2018.	4	4
4.2	Muhamed Tairi, Veton Ademi, Kujtim Rexhepi. "Praktikum i Kujdesit Mjekësor I", Tetovë 2015.	4	4
	<b>Totali i pikëve nga veprimtaria mësimore-arsimore</b>		<b>43.92</b>

## VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Nr.	Emri i aktivitetit	Pikët
<b>1</b>	<b>Teza të mbrojtura</b>	/
1.1	“Karakteristikat antropometrike të fëmijëve dhe rinisë në rajonin e Pollogut”, teza e mbrojtur e doktoraturës, programi studimor: Biomedicinë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti i Tetovës, Tetovë, 2021	/
1.2	“Incidenca e Diabetes Mellitus në Tetovë dhe rrethinë”, teza e mbrojtur e magistraturës, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë 2013	/
<b>2</b>	<b>Punim me rezultate origjinale shkencore, të botuar në revistë referente shkencore/profesionale me bord editorial ndërkombëtar</b>	<b>20.4</b>
2.1	<b>Ademi V</b> , Bexheti S, Behluli I, Zylbeari L, Tairi M. “Anthropometric characteristics of schoolchildren and adolescents in the Tetovo region“, Medical Journal MEDICUS, 2020, Vol. 25 (1): 82-88, ISSN 1409-6366 UDC 61.	3.6
2.2	<b>Ademi V</b> , Zylbeari L, Behluli I. “Impact of the socioeconomic status on anthropometric parameters in children and adolescents: systematic review of the literature“, Medical Journal MEDICUS, 2019, Vol. 24 (1): 94-102, ISSN 1409-6366 UDC 61.	4.8
2.3	Shatri J, Çerkezi S, <b>Ademi V</b> , Reçi V, Bexheti S. “Anatomical variations and dimensions of arteries in the anterior part of the circle of Willis”, Folia Morphologica, 2018, ISSN: 0015-5659, DOI: 10.5603 / FM.a2018. 0095, Pubmed: 30311936	3.6
2.4	Tairi M, Tozija F, <b>Ademi V</b> . “Legislative framework for the protection of patients in Macedonia“.Medical Journal MEDICUS, 2017, Vol. 22 (2): 238 -245, ISSN 1409-6366 UDC 61.	4.8
2.5	Ahmeti S, Bexheti S, <b>Ademi V</b> , Alili E, Malaj L. “Inpatient vs Outpatient: A cost comparison of the use of low molecular weight Heparins during pregnancy” Acta Medica Balkanica, 2018, Vol. 3 (6): 57-64, ISSN 2545-4110 UDC 61.	3.6
<b>3</b>	<b>Punim me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në përmbledhje punimesh nga tubim shkencor me bord ndërkombëtar</b>	<b>13.2</b>
3.1	<b>Ademi V</b> , Bexheti S, Elezi B, Bexheti E. “Anthropometric characteristics in young people aged 12 to 17 years old in the Polog region, North Macedonia”. 6. International Istanbul Scientific Research Congress, October 30-31 2021, Istanbul Turkey (Online participation)	1.8
3.2	Bexheti S, <b>Ademi V</b> , Bexheti E, Elezi B, Bexheti D. “Variability of verrucae hippocampi in the human gyrus parahippocampalis”. 7. Kongres Srpskog Anatomskog Drustva Srbije, 9-11 December 2021, Belgrade, Serbia (Online participation)	1.8
3.3	<b>Ademi V</b> , Zylbeari L, Behluli I. “Anthropometric characteristics in children aged 7 to 11 years old in primary schools in the region of Prishtina”. 3 <sup>rd</sup> International Scientific Conference of Faculty of Medical Sciences, 8 - 10 November 2018, Ohrid, Macedonia. ISBN 978-608-217-075-6.	2.4
3.4	Bexheti S, Çerkezi S, <b>Ademi V</b> , Shatri J. “Clinical importance of the areas of cortex, functional lateralization, dominance and asymmetry in the human brain”. 3 <sup>rd</sup> International Scientific Conference of Faculty of Medical Sciences, 8 - 10 November 2018, Ohrid, Macedonia. ISBN 978-608-217-075-6.	1.8
3.5	Bexheti S, Çerkezi S, <b>Ademi V</b> , Reçi V, Bexheti D, Shatri J. “Modular variability in the human entorhinal cortex”. 6th Congress of Serbian Anatomical Society, 7 - 9 September 2018. Zlatibor, Serbia.	1.8

3.6	Çerkezi S, Shatri J, Ballazhi M, <b>Ademi V</b> , Bexheti S. "Anatomical variations of arteries in the posterior part of the circle of Willis on MRI angiography". 6 <sup>th</sup> Congress of Serbian Anatomical Society, 7 - 9 September 2018. Zlatibor, Serbia.	1.8
3.7	Ahmeti S, <b>Ademi V</b> , Rufati N, Behxheti M, Qaili A, Malaj L. "Analizë farmakoeconomike: Përdorimi irracional i Heparinës me masë molekulare të ulët gjatë shtatzanisë". Konferenca e Dytë e Farmacisë me pjesëmarrje ndërkombëtare, Prizren 2-4 Qershor 2017. ISBN 978-9951-460-38-5	1.8
<b>4</b>	<b>Pjesëmarrje në takim shkencor/profesional me referat - prezentim oral</b>	<b>7.6</b>
4.1	<b>Ademi V</b> , Bexheti S, Elezi B, Bexheti E. "Anthropometric characteristics in young people aged 12 to 17 years old in the Polog region, North Macedonia". 6. International Istanbul Scientific Research Congress, October 30-31 2021, Istanbul Turkey (Online participation)	1.2
4.2	Bexheti S, <b>Ademi V</b> , Bexheti E, Elezi B, Bexheti D. "Variability of verrucae hippocampi in the human gyrus parahippocampalis". 7. Kongres Srpskog Anatomskog Drustva Srbije, 9-11 December 2021, Belgrade, Serbia (Online participation)	1.2
4.3	<b>Ademi V</b> , Zylbeari L, Behluli I. "Anthropometric characteristics in children aged 7 to 11 years old in primary schools in the region of Prishtina". 3 <sup>rd</sup> International Scientific Conference of Faculty of Medical Sciences, 8 - 10 November 2018, Ohrid, Macedonia.	1.6
4.4	Ahmeti S, Bexheti D, Qaili A, <b>Ademi V</b> , Qaili F, "Rational use of low molecular weight heparins during pregnancy. Cost consideration". International Congress on Natural, Health Sciences and Technology, Tetovo 15-17 May 2018	1.2
4.5	Bexheti S, Çerkezi S, <b>Ademi V</b> , Shatri J. "Clinical importance of the areas of cortex, functional lateralization, dominance and asymmetry in the human brain". 3 <sup>rd</sup> International Scientific Conference of Faculty of Medical Sciences, 8 - 10 November 2018, Ohrid, Macedonia.	1.2
4.6	Ahmeti S, <b>Ademi V</b> , Rufati N, Behxheti M, Qaili A, Malaj L. "Analizë farmakoeconomike: Përdorimi irracional i Heparinës me masë molekulare të ulët gjatë shtatzanisë". Konferenca e Dytë e Farmacisë me pjesëmarrje ndërkombëtare, Prizren 2-4 Qershor 2017.	1.2
<b>5</b>	<b>Pjesëmarrje në takim shkencor/profesional me referat - prezentim poster</b>	<b>2.4</b>
5.1	Bexheti S, Çerkezi S, <b>Ademi V</b> , Reçi V, Bexheti D, Shatri J. "Modular variability in the human entorhinal cortex". 6 <sup>th</sup> Congress of Serbian Anatomical Society, 7 - 9 September 2018. Zlatibor, Serbia.	1.2
5.2	Çerkezi S, Shatri J, Ballazhi M, <b>Ademi V</b> , Bexheti S. "Anatomical variations of arteries in the posterior part of the circle of Willis on MRI angiography". 6 <sup>th</sup> Congress of Serbian Anatomical Society, 7 - 9 September 2018. Zlatibor, Serbia.	1.2
<b>6</b>	<b>Abstrakt i botuar në librin e abstrakteve nga konferencat shkencore - ndërkombëtare</b>	<b>5</b>
6.1	<b>Ademi V</b> , Bexheti S, Elezi B, Bexheti E. "Anthropometric characteristics in young people aged 12 to 17 years old in the Polog region, North Macedonia". 6. International Istanbul Scientific Research Congress, October 30-31 2021, Istanbul Turkey (Online participation)	0.6
6.2	Bexheti S, <b>Ademi V</b> , Bexheti E, Elezi B, Bexheti D. "Variability of verrucae hippocampi in the human gyrus parahippocampalis". 7. Kongres Srpskog Anatomskog Drustva Srbije, 9-11 December 2021, Belgrade, Serbia (Online participation)	0.6
6.3	<b>Ademi V</b> , Zylbeari L, Behluli I. "Anthropometric characteristics in children aged 7 to 11 years old in primary schools in the region of Prishtina". 3 <sup>rd</sup>	0.8

	International Scientific Conference of Faculty of Medical Sciences, 8 - 10 November 2018, Ohrid, Macedonia. ISBN 978-608-217-075-6.	
6.4	Ahmeti S, Bexheti D, Qaili A, <b>Ademi V</b> , Qaili F, "Rational use of low molecular weight heparins during pregnancy. Cost consideration". International Congress on Natural, Health Sciences and Technology, Tetovo 15-17 May 2018. ISBN 978-608-217-078-7.	0.6
6.5	Bexheti S, Çerkezi S, <b>Ademi V</b> , Shatri J. "Clinical importance of the areas of cortex, functional lateralization, dominance and asymmetry in the human brain". 3 <sup>rd</sup> International Scientific Conference of Faculty of Medical Sciences, 8 - 10 November 2018, Ohrid, Macedonia. ISBN 978-608-217-075-6.	0.6
6.6	Bexheti S, Çerkezi S, <b>Ademi V</b> , Reçi V, Bexheti D, Shatri J. "Modular variability in the human entorhinal cortex". 6 <sup>th</sup> Congress of Serbian Anatomical Society, 7 - 9 September 2018. Zlatibor, Serbia.	0.6
6.7	Çerkezi S, Shatri J, Ballazhi M, <b>Ademi V</b> , Bexheti S. "Anatomical variations of arteries in the posterior part of the circle of Willis on MRI angiography". 6 <sup>th</sup> Congress of Serbian Anatomical Society, 7 - 9 September 2018. Zlatibor, Serbia.	0.6
6.8	Ahmeti S, <b>Ademi V</b> , Rufati N, Behxheti M, Qaili A, Malaj L. "Analizë farmakoekonomike: Përdorimi irracional i Heparinës me masë molekulare të ulët gjatë shtatzanisë". Konferenca e Dytë e Farmacisë me pjesëmarrje ndërkombëtare, Prizren 2-4 Qershor 2017. ISBN 978-9951-460-38-5	0.6
	<b>Totali i pikëve nga veprimtaria shkencore - hulumtuese</b>	<b>48.6</b>

#### VEPRIMTARIA PROFESIONALE - APLIKATIVE

Nr.	Emri i aktivitetit:	Pikët
<b>1</b>	<b>Pjesëmarrje në aktivitete</b>	<b>4</b>
1.1	Prezantimi i ofertës akademike të Universitetit të Tetovës në shkollat e mesme për vitin akademik 2018/2019	1
1.2	Prezantimi i ofertës akademike të Universitetit të Tetovës në shkollat e mesme për vitin akademik 2019/2020	1
1.3	Prezantimi i ofertës akademike të Universitetit të Tetovës në shkollat e mesme për vitin akademik 2020/2021	1
1.4	Pjesëmarrje në hartimin e elaboratit për akreditim, përkatësisht riakreditimin e programeve studimore: Infermieri, Mami dhe Fizioterapi	1
	<b>Totali i pikëve nga veprimtaria profesionale aplikative</b>	<b>4</b>

#### VEPRIMTARIA ME INTERES TË GJËRË

Nr.	Emri i aktivitetit	Pikët
<b>1</b>	<b>Anëtar i këshillit organizues ose programor i tubimit ndërkombëtar shkencor/profesional</b>	<b>3</b>
1.1	Konferenca e dytë shkencore ndërkombëtare "Healthcare challenges of the 21st century", Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti i Tetovës, 13 - 14 Tetor 2017	1
1.2	Konferenca e tretë shkencore ndërkombëtare, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti i Tetovës, 8 - 10 Nëntor 2018	1



1.3	Konferenca e katërt shkencore ndërkombëtare, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti i Tetovës, 15 - 17 Maj 2019	1
<b>2</b>	<b>Anëtar i bordit redaktues të revistës shkencore/profesionale ndërkombëtare</b>	<b>1</b>
2.1	Bordi editorial: "Acta Medica Balkanica" - International Journal of Medical Sciences, ISSN: 2545 - 4110.	1
<b>3</b>	<b>Anëtar i komisionit të universitetit</b>	<b>3</b>
3.1	Anëtar i Komisionit për rangimin e studentëve në ciklin e parë të studimeve (viti akademik 2019/2020)	1
3.2	Anëtar i Komisionit për rangimin e studentëve në ciklin e parë të studimeve (viti akademik 2020/2021)	1
3.3	Anëtar i Komisionit për provim pranues të studentëve në ciklin e parë të studimeve (viti akademik 2020/2021)	1
<b>4</b>	<b>Pozitë udhëheqëse</b>	<b>4</b>
4.1	Përgjegjës i programit studimor: Fizioterapi, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti i Tetovës, Tetor 2016 - Tetor 2017	1
4.2	Koordinator për ECTS, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti i Tetovës, Tetor 2017 - Tetor 2021	3
<b>5</b>	<b>Qëndrim studimor</b>	<b>2</b>
5.1	Qëndrim studimor dy javor në Universitetin e Trakias, Edrene, Turqi. 01.08.2015-14.08.2015.	1
5.2	Qëndrim studimor një javor në Universitetin e Prishtinës, Prishtinë, Kosovë. 15.05.2019-30.05.2019.	1
	<b>Totali i pikëve nga veprimtaria me interes të gjërë</b>	<b>13</b>

### Shkurt 2022, Tetovë

### Komisioni recensues:

1. Prof.Dr. Sadi Bexheti (kryetar)

---

2. Prof.Dr. Lutfi Zylbeari (anëtar)

---

3. Doc.Dr. Muhamed Tairi (anëtar)

---

**DREJTUAR:**  
**KËSHILLIT MËSIMOR – SHKENCOR TË**  
**FAKULTETIT TË SHKENCAVE MJEKËSORE**

**RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES**

Me vendim të Këshillit Mësimor Shkencor të Fakultetit të Shkencave Mjekësore të Universitetit të Tetovës, me numër arkivi 22-3919/1 të datës 14.12.2021 dhe në bazë të konkursit të shpallur më: 25.12.2021 në gazetën ditore “Koha” dhe “Sloboden pecat”, është caktuar komisioni recensues - Vendim me numer arkivi 22-172/1 të datës 03.02.2022, për zgjedhjen e një mësimdhënësi në thirrjen mësimore-shkencore Docent për lëmitë: Bioteknologji (30608) dhe Tjera (30616), nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjëve shkencorë – hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit, me këtë përbërje:

- 1. Prof. Dr. Dorentina Bexheti, profesor inordinar në Fakultetin e Shkencave Mjekësore, Universiteti i Tetovës – kryetar**
- 2. Prof. Dr. Bistra Angelovska – profesor ordinar në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti “Goce Delçev”, Shtip – anëtar**
- 3. Doc. Dr. Edita Alili Idrizi – docent në Fakultetin e Shkencave Mjekësore, Universiteti i Tetovës - anëtar.**

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të pranuar, komisioni paraqet këtë:

## REFERAT

I. Në bazë të Vendimit me nr: 22-3919/1 të datës 14.12.2021 të Këshillit Mësimor Shkencor të Fakultetit të Shkencave Mjekësore, në Universitetin e Tetovës, lidhur me konkursin për zgjedhjen e mësimdhënësit në thirrjen mësimore-shkencore **Docent** për lëmitë Bioteknologji dhe të tjera, të shpallur në të përditshmen “Koha” dhe “Sloboden pecat” të datës 25.12.2021, u paraqit vetëm një kandidat:

### 1. Dr.sc. Sihana Ahmeti Lika.

#### I.I. Të dhëna biografike dhe zhvillimi profesional

Kandidatja, Dr.sc. Sihana Ahmeti Lika ka lindur më 16.07.1985 në Tetovë, komuna e Tetovës, Republika e Maqedonisë së Veriut. Arsimin fillor e kreu në shkollën “Naim Frashëri” ndërsa shkollën e mesme në ShMKM “Nikolla Shtejn” në Tetovë. Në vitin 2004 regjistrohet në Fakultetin e Shkencave Matematiko Natyrore – Programi studimor i Farmacisë në Universitetin Shtetëror të Tetovës, ku edhe u diplomua në vitin 2009 me notë mesatare **8.68**.

Në vitin 2012, Dr.sc. Sihana Ahmeti Lika u regjistrua në studime të doktoraturës në Fakultetin e Mjekësisë, departamenti i Farmacisë, në Universitetin e Mjekësisë në Tiranë. Disertacionin me titull “*Përshkrimi racional i heparinës me peshë molekulare të vogël gjatë shtatzanisë*” e mbrojti me sukses të shkëlqyeshëm, me 21.10.2020 dhe mori titullin **Doktor në Shkencat Farmaceutike**.

Aktualisht, është në vit të fundit të specializimit në fushën e **Teknologjisë farmaceutike**.

Gjatë studimeve të saj, Dr.sc. Sihana Ahmeti Lika, përveç arsimit formal, u trajnuar edhe përmes edukimit joformal, ku mori një sërë certifikatash nga trajnime dhe seminare, gjë që i mundësoi asaj të përfitojë shkathësi të ndryshme jetësore dhe profesionale.

Nga periudha shtator 2009 deri në korrik 2010 është angazhuar në Universitetin e Tetovës si bashkëpunëtorë e jashtëme, asistent në Programin studimor të Farmacisë.

Në korrik të vitit 2010, zgjidhet bashkëpunëtorë, në thirrjen asistente e re në Fakultetin e Shkencave Mjekësore, programi studimor Farmaci, në Universitetin e Tetovës. Gjatë viteve akademike 2009-2021 ka mbajtur ushtrime dhe ligjerata në lëndët: Kimi analitike, Botanikë farmaceutike, Farmakognozi, Bazat e fitoterapisë, Hulumtim dhe kontroll i barnave, Bazat e teknologjisë farmaceutike, Teknologji farmaceutike dhe Teknologji farmaceutike – Kursi i lartë. Angazhimin e vet profesional në këtë moment e realizon me titullin e njëjtë, e caktuar në marrëdhënie të rregullt pune në Universitetin e Tetovës.

Nga shtatori i vitit 2016 deri ne shtator të vitit 2017 ka ushtruar funksionin Përgjegjëse e programit studimor Mjekësi e përgjithshme.

Në shtator të vitit 2017 emërohet në postin Prodekan për Arsim, në Fakultetin e Shkencave Mjekësore, detyrë kjo e cila përmbyllet në mars të vitit 2021. Në periudhën e angazhimeve të saj kandidatja, Dr.sc Sihana Ahmeti Lika tregoi profesionalizëm dhe përkushtim të madh organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor.

Kandidatja, mbi 45 herë ka marrë pjesë si anëtare e Komisionit për vlerësim dhe mbrojtje të punimeve të diplomës.

E gjithë kjo flet në mënyrë të mjaftueshme për përvojën e Dr.sc Sihana Ahmeti Lika që e ka fituar në të gjitha fushat në të cilat ka qenë e angazhuar dhe në të cilat ka dhënë rezultate të shkëlqyeshme.

Dr.sc Sihana Ahmeti Lika është anëtare e bordit shkencor në revistën “*ACTA MEDICA BALKANICA International Journal of Medical Sciences*”.

Ajo ka marrë pjesë aktive në organizimin e katër konferencave të FSHM:

*First International Scientific Conference of Faculty of Medical Sciences (ISCFMSC 2016)*

*Second International Scientific Conference of the Faculty of Medical Sciences (ISCFMSC 2017).*

*3<sup>rd</sup> International Scientific Conference of the Faculty of Medical Sciences (ISCFMSC 2018)*

*4<sup>th</sup> International Scientific Conference of the Faculty of Medical Sciences (ISCFMSC 2019)*

Gjatë periudhës 2017-2020 ka qenë anëtare e komisionit për rangim të kandidatëve për studim në ciklin e parë dhe në vitin 2020 ka qenë anëtare komisioni për provimin pranues të studentëve të ciklit të parë, për programet studimore: Mjekësi e përgjithshme, Farmaci dhe Stomatologji.

Kandidatja posedon çertifikatë ndërkombëtare APTIS për njohje të gjuhës angleze (**niveli C**).

## **II. Veprimtaria mësimore-arsimore**

### **A. Mbajtja e mësimimit (ushtrime dhe ligjërata)**

Kandidatja, Dr.Sc. Sihana Ahmeti Lika ka mbajtur mësim në këto lëndë:

- Kimi analitike,
- Botanikë farmaceutike,
- Farmakognozi,
- Bazat e fitoterapisë,
- Hulumtim dhe kontroll i barnave,
- Bazat e teknologjisë farmaceutike,
- Teknologji farmaceutike dhe
- Teknologji farmaceutike – Kursi i lartë.

### **B. Skripta interne për ligjërata dhe ushtrime**

“Teknologji farmaceutike – Kursi i lartë”

“Ditar - Praktika Profesionale”

Në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën e zgjedhjes në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës (Buletini i Universitetit), kandidatja Dr.sc. Sihana Ahmeti Lika ka realizuar gjithsej **191.24** pikë nga veprimtaria mësimore arsimore.

## **III. Veprimtaria shkencore-hulumtuese**

Si segment i rëndësishëm në aktivitetin e gjithanshëm të Dr.sc Sihana Ahmeti Lika është edhe puna e saj kërkimore-shkencore, e kjo jo vetëm për shkak të numrit të konsiderueshëm të punimeve shkencore, në të cilat ajo është nënshkruar si autor, ose bashkautor, madje edhe për shkak të aktualitetit të temave që i trajton.

Një pjesë të botimeve i ka prezantuar në konferenca dhe simpoziume shkencore ndërkombëtare dhe një pjesë i ka botuar në revista shkencore ndërkombëtare.

## A. Punime shkencore

Kandidatja i ka publikuar këto punime:

1. Drita Yzeiri Havziu, Biljana Gjorgjevska, Edita Alili Idrizi, Gjylaj Alija, **Sihana Lika**, Merita Dauti. Monitoring Of The Renal Function In Piroxicam Treated Patients. Knowledge-International Jurnal, Scientific Papers. ISSN: 2545-4439. Vol.38.4 (4). pp. 819-824. 2020
2. Gjylai Alija, Zehra Hajrullai-Musliu, Risto Uzunov, **Sihana Ahmeti Lika**, Drita Havziu. Determination of cephalosporin antibiotic residues in milk using liquid chromatography – tandem mass spectrometry (LC – MS/MS) method. Acta Medica Balkanica, International Journal of Medical Sciences. ISSN: 2545-4110 (Print), ISSN: 2545-4870 (Online). Vol.5, Issue 9-10. pp.39-45. 2020
3. Edita Alili - Idrizi, **Sihana Ahmeti Lika**, Merita Dauti, Lulzime Ballazhi, Flora Doko, Healthcare professionals' knowledge, attitudes and practices towards pharmacovigilance. Acta Medica Balkanica, International Journal of Medical Sciences. ISSN: 2545-4110 (Print), ISSN: 2545-4870 (Online) Vol.4, Issue 7-8. Pp. 23-30. 2019
4. Merita Dauti, Arlinda Haxhiu-Zajmi, Edita Alili-Idrizi, **Sihana Ahmeti Lika**, Gjylai Alija, *difficulties* in the *liberalization* of the market of otc medications in republic of north macedonia and experiences from european countries. Acta Medica Balkanica, International Journal of Medical Sciences. ISSN: 2545-4110 (Print), ISSN: 2545-4870 (Online) Vol.4, Issue 7-8. pp. 86-90. 2019
5. **Sihana Ahmeti Lika**, Dorentina Bexheti, Veton Ademi, Edita Alili Idrizi, Ledjan Malaj. Inpatient vs. Outpatient: a cost comparison of the use of low molecular weight heparins during pregnancy. Acta Medica Balkanica, International Journal of Medical Sciences. ISSN: 2545-4110 (Print) ISSN: 2545-4870 (Online) Vol. 3, Issue 6, pp. 57-64, 2018
6. Merita Dauti, Edita Alili Idrizi, **Sihana Ahmeti Lika**, Arlinda Haxhiu Zajmi, Ledjan Malaj. The impact of legal changes in the pharmaceutical sector in Macedonia – An analysis based on the pharmacists' opinions and viewpoints. Acta Medica Balkanica, International Journal of Medical Sciences. ISSN:2545-41110 (Print), Vol.2, Issue 3-4, pp.53-59, 2017
7. Lulzime Ballazhi, Edita Alili Idrizi, Merita Dauti, **Sihana Ahmeti Lika**. A review of coumarin, thiazole and isoxazole derivatives in pharmacotherapy. Acta Medica Balkanica, International Journal of Medical Sciences. ISSN:2545-41110 (Print), Vol.2, Issue 3-4, pp.91-96. 2017
8. **Sihana Ahmeti Lika**, Arbnore Qaili, Gjylai Alija, Arlinda Haxhiu, Veton Ademi. Pershkrimi iracional i heparines me mase te vogel molekulare gjate shtatzenise. Acta Medica Balkanica, International Journal of Medical Sciences. ISSN: 2545-4110 (Print). Vol.1, Issue 2. pp. 63-71. 2016
9. Merita Dauti, Edita Alili-Idrizi, Arlinda Haxhiu-Zajmi, Lulzime Ballazhi, **Sihana Ahmeti Lika**. Reformimi i legjislacionit farmaceutik ne Maqedoni: Reflektim mbi vështirësitë

dhe oportunitetet për zbatimin e ndryshimeve të reja. Acta Medica Balkanica, International Journal of Medical Sciences. ISSN: 2545-4110 (Print). Vol.1, Issue 2. pp. 103-107. 2016.

10. **Sihana Ahmeti Lika**, Nagip Rufati, Merita Dauti, Ledjan Malaj. High prescription of Low Molecular Weight Heparins during pregnancy in a Hospital in Tetovo, The Republic of Macedonia. European Scientific Journal. ISSN: 1857 – 7881 (Print) e - ISSN 1857- 7431, Vol.11, Issue.30, pp.79-87. 2015.

11. **Sihana Ahmeti Lika**, Merita Dauti, Ledjan Malaj. Management of Hypercoagulable state during pregnancy. Prophylactic usage of Low Molecular Weight Heparin (LMWH). European Scientific Journal. ISSN: 1857 – 7881 (Print) e - ISSN 1857- 7431. pp. 112-118. 2015.

12. **Sihana Ahmeti Lika**, Bujar H. Durmishi, Agim Shabani, Merita Dauti, Ledjan Malaj. Antithrombotic Therapy During Pregnancy. ARC Journal of Pharmaceutical Sciences (AJPS). Volume 1, Issue 2, ISSN: 2455-1538. pp 16-20. 2015

13. Merita Dauti, Edita Alili- Idrizi, **Sihana Ahmeti Lika**, Ledjan Malaj. Overview on generics policies and pharmaceutical pricing in the European Countries and the Republic of Macedonia. ISSN: 1857 – 7881 (Print) e - ISSN 1857- 7431. Vol.11, Issue 3. pp. 302-308.

14. **Sihana Ahmeti Lika**, Merita Dauti, Ledjan Malaj, Low molecular weight heparine during pregnancy. International Conference on Medical, Biological and Pharmaceutical Sciences. World Academy of Science, Engineering and Technology. ISSN: 1307-6892 28-29. November, 2014 Istanbul, Turkey.

15. Merita Dauti, Edita Alili-Idrizi, **Sihana Ahmeti Lika**, Ledjan Malaj. Legal Regulation and Critical Analysis for an Effectively Treatment of Pharmaceutical Waste. International Conference on Medical, Biological and Pharmaceutical Sciences. World Academy of Science, Engineering and Technology. ISSN: 1307-6892. 28-29 November, 2014 Istanbul, Turkey.

Gjatë leximit të punimeve të botuara të Dr.sc Sihana Ahmeti Lika, të bashkangjitura në dosjen e saj, vërehet përkushtimi i thellë, dhe zgjedhja origjinale e temave. Njëherit ajo tregon vështrim të pjekur me problemet që i trajton, duke e shfrytëzuar në tërësi qasjen metodike-shkencore gjatë prezantimit, observimit dhe nxjerrjes së konstatimeve përkatëse. Shfrytëzon në mënyrë selektive literaturën përkatëse, që mundëson të shihet se kandidatja shërbehet me burime relevante dhe është në gjendje t'i prezantojë njohuritë e veta në një nivel të lartë shkencor dhe estetik.

## **B. Tubime shkencore**

1. **Sihana Ahmeti Lika**, Dorentina Bexheti, Edita Alili Idrizi, Merita Dauti, Hanife Rustemi Ahmeti. Small-scale preparation of radiopharmaceuticals. In the proceedings of the “Baskent” Congress on Physical, Social and Health Sciences. December 4-5, 2021. Pp. 520. ISBN: 978-605-71167-0-3. Turkey

2. Lulzime Ballazhi, Dorentina Bexheti, Edita Alili Idrizi, Merita Dauti, Drita Havziu, Arlinda Haxhiu Zajmi, **Sihana Ahmeti Lika**, Adelina Murati. Pharmacokinetic drug interactions

with Hypericum Perforatum plant. In the proceedings of the “Baskent” Congress on Physical, Social and Health Sciences. December 4-5, 2021. Pp.521. ISBN: 978-605-71167-0-3. Turkey

3. Drita Yzeiri, Biljana Gjorgjeska, Visar Miftari, Edita Alili Idrizi, Gjylai Alija, Arlinda Haxhiu Zajmi, Merita Dauti, **Sihana Ahmeti Lika**, Lulzime Ballazhi. Migraine and the effects of NSAID on renal function. In the proceedings of the “Baskent” Congress on Physical, Social and Health Sciences. December 4-5, 2021. Pp.489-495. ISBN: 978-605-71167-0-3. Turkey

4. Merita Dauti, Dorentina Bexheti, Edita Alili Idrizi, Lulzime Ballazhi, Drita Yzeiri Havziu, Arlinda Haxhiu Zajmi, **Sihana Ahmeti Lika**. The role of pharmacist in educating patients for a better adherence to medication. In the proceedings of the “Baskent” Congress on Physical, Social and Health Sciences. December 4-5, 2021. Pp.573. ISBN: 978-605-71167-0-3. Turkey

5. Arlinda Haxhiu Zajmi, Dorentina Bexheti, Drita Yzeiri Havziu, Edita Alili Idrizi, Lulzime Ballazhi, Merita Dauti, **Sihana Ahmeti Lika**. Classification and registration of borderline products. In the proceedings of the “Baskent” Congress on Physical, Social and Health Sciences. December 4-5, 2021. Pp.601. ISBN: 978-605-71167-0-3. Turkey

6. **Sihana Ahmeti Lika**, Arlinda Haxhiu Zajmi, Dorentina Bexheti, Drita Yzeiri, Edita Alili Idrizi, Lulzime Ballazhi, Merita Dauti. How are radiopharmaceuticals regulated? In Proceedings of the 6<sup>th</sup> International Istanbul Scientific Research Congress. **October 30-31. 2021.** pp. 485. ISBN: 978-605-74191-8-7. Turkey

7. Lulzime Ballazhi, Dorentina Bexheti, Edita Alili-Idrizi, Merita Dauti, Drita Havziu, Arlinda Haxhiu-Zajmi, **Sihana Ameti-Lika**. Common drug interaction with milk. In Proceedings of the 6<sup>th</sup> International Istanbul Scientific Research Congress. **October 30-31. 2021.** pp. 487. ISBN: 978-605-74191-8-7. Turkey

8. Edita Alili-Idrizi, Dorentina Bexheti, Lulzime Ballazhi, Drita Yzeiri Havziu, Merita Dauti, Arlinda Haxhiu-Zajmi, **Sihana Ahmeti-Lika**, Hanife Rustemi Ahmeti, Arbnore Qaili-Nazifi, Almedina Xheladini. Evaluation of rational drug use based on who prescribing indicators in pediatric inpatients with diarrhea. In Proceedings of the 6<sup>th</sup> International Istanbul Scientific Research Congress. **October 30-31. 2021.** pp. 541. ISBN: 978-605-74191-8-7. Turkey

9. Merita Dauti , Dorentina Bexheti, Edita Alili-Idrizi, Lulzime Ballazhi, Drita Havziu, Arlinda Haxhiu-Zajmi, **Sihana Ameti Lika**. A critical overview of the current situation on uncontrolled use of otc drugs. In Proceedings of the 6<sup>th</sup> International Istanbul Scientific Research Congress. **October 30-31. 2021.** pp. 580. ISBN: 978-605-74191-8-7. Turkey



10. Arlinda Haxhiu Zajmi, Dorentina Bexheti, Drita Yzeiri Havziu, Edita Alili Idrizi, Lulzime Ballazhi, Merita Dauti, **Sihana Ahmeti Lika**. New rules-regulations to improve patient safety from falsified medicines. In Proceedings of the 6<sup>th</sup> International Istanbul Scientific Research Congress. **October 30-31, 2021**. pp. 603. ISBN: 978-605-74191-8-7. Turkey

11. Edita Alili-Idrizi, Dorentina Bexheti, **Sihana Ahmeti Lika**, Merita Dauti, Arlinda Haxhiu-Zajmi, Lulzime Ballazhi. Internal Audit as a Management Tool in Pharmaceutical Industry. 10<sup>th</sup> UBT Annual International Conference on Pharmaceutical and Natural Sciences IC-PNS 202. October 29, 2021. pp.324. ISBN: 978-9951-550-47-5 Pristina

12. Merita Dauti, Edita Alili-Idrizi, Alinda Haxhiu-Zajmi, **Sihana Ahmeti Lika**, Drita Havziu. Preventing OTC drug abuse - new challenges for the pharmacist community in pandemic crisis. 10<sup>th</sup> UBT Annual International Conference on Pharmaceutical and Natural Sciences IC-PNS 202. October 29, 2021. pp. 313. ISBN: 978-9951-550-47-5 Pristina

13. Lulzime Ballazhi, Edita Alili-Idrizi, Merita Dauti, Arlinda Haxhiu Zajmi, **Sihana Ahmeti Lika**. Interactions between drugs in patients with chronic polytherapy. 10<sup>th</sup> UBT Annual International Conference on Pharmaceutical and Natural Sciences IC-PNS 202. October 29, 2021. pp.314. ISBN: 978-9951-550-47-5 Pristina

14. Drita Yzeiri Havziu, Biljana Gjorgjeska, Visar Miftari, Edita Alili Idrizi, Gjylaj Alija, Arlinda Haxhiu Zaimi, Merita Dauti, **Sihana Ahmeti Lika**, Lulzime Balazhi. Evaluation a renal function of patients with Medication-overuse headache (MOH). 10<sup>th</sup> UBT Annual International Conference on Pharmaceutical and Natural Sciences IC-PNS 202. October 29, 2021.pp.325. ISBN: 978-9951-550-47-5 Pristina

15. Gjylai Alija, Zehra Hajrullai Musliu, Drita Havziu, Merita Dauti, **Sihana Ahmeti Lika**, Lulzime Ballazhi. Antibiotic Residues in Milk: Human health Risk – A review. 1<sup>st</sup> Congress of Pharmacy. 2-3 November 2019. Pristina

16. **Sihana Ahmeti Lika**, Dorentina Bexheti, Arbnore Qaili, Veton Ademi, Florentina Qaili, “Rational Use of Low Molecular Weight Heparin during pregnancy. Cost Considerations”, International Congress on Natural, Health Sciences and Technology; 4<sup>th</sup> International Scientific Conference of the Faculty of Medical Sciences, ISBN: 9-786082-170787, 15-17 May, 2019, Tetova, Republic of North Macedonia

17. Mikaela Kolaci, Leonard Deda, Alma Idrizi, **Sihana Ahmeti Lika**. Therapeutic monitoring of mycophenolic acid in renal transplanted patients by a validated HPLC method. International Congress on Natural, Health Sciences and Technology; 4<sup>th</sup> International Scientific

Conference of the Faculty of Medical Sciences, ISBN: 9-786082-170787, 15-17 May, 2019, Tetova, Republic of North Macedonia

**18. Sihana Ahmeti Lika**, Dorentina Bexheti, Florentina Qaili, “Use of the molecular weight heparin Nadroparin during pregnancy”, 3<sup>rd</sup> International Scientific Conference of the Faculty of Medical Sciences, ISBN: 9-786082-1707 -6, 08-10 2018 November, Ohrid Macedonia

**19.** Dorentina Bexheti, Edita Alili Idrizi, **Sihana Ahmeti Lika**. Prediction of plerixafor pharmacokinetics in mice using PCMODFIT Software. 3<sup>rd</sup> International Scientific Conference of the Faculty of Medical Sciences, ISBN: 9-786082-1707 -6, 08-10 2018 November, Ohrid Macedonia

**20. Sihana Ahmeti Lika**, Dorentina Bexheti, Hanife Rustemi Ahmeti, Ledjan Malaj, Estimated Cost of Inpatient vs. Outpatient Treatment with Anticoagulants during Pregnancy, 2<sup>nd</sup> International Scientific Conference of the Faculty of Medical Sciences, ISBN: 978-608-217-062-6, 13-14 October, 2017 Tetova, Macedonia.

**21.** Dorentina Bexheti, **Sihana Ahmeti Lika**. LC – MS/MS assays in Support of Metabolite and Epigenetic Marker Correlation. 2<sup>nd</sup> International Scientific Conference of the Faculty of Medical Sciences, ISBN: 978-608-217-062-6, 13-14 October, 2017 Tetova, Macedonia.

**22. Sihana Ahmeti Lika**, Veton Ademi, Nagip Rufati, Mirlind Behxheti, Arbnore Qaili, Ledjan Malaj, Pharmacoeconomic Analysis: Irrational utilisation of low molecular weight heparins during pregnancy, II-nd Pharmacy Conference with international participation, ISBN: 978-9951-460-38-5, 02-04/06/2017, Prizren, Kosovo.

**23. Sihana Ahmeti Lika**, Merita Dauti, Edita Alili Idrizi, Ledjan Malaj. Treatment of hypercoagulable state during pregnancy and prophylactic usage of Low Molecular weight heparine (LMWH). 2<sup>nd</sup> International Pharmaceutical Conference. pp. 32-33 ISBN: 978-9951-460-26-2. 19-21 September 2014 Prizren, Kosovo.

**24.** Edita Alili-Idrizi, **Sihana Ahmeti Lika**, Merita Dauti, Ledjan Malaj. Assessment of antimicrobial drug use indicators in pediatric hospital in Tetovo. ). 2<sup>nd</sup> International Pharmaceutical Conference. pp. 40 – 41. ISBN: 978-9951-460-26-2. 19-21 September 2014 Prizren, Kosovo.

**25.** Merita Dauti, Edita Alili Idrizi, **Sihana Ahmeti Lika**, Ledjan Malaj. Pharmaceutical Legislation changes in the Republic of Macedonia – Review and comparative analysis of the EU

member countries. 2<sup>nd</sup> International Pharmaceutical Conference. pp. 96 – 97. ISBN: 978-9951-460-26-2. 19-21 September 2014 Prizren, Kosovo.

**26. Sihana Ahmeti Lika.** Usage of Low molecular weight heparine during pregnancy. 6<sup>th</sup> International Medical Conference of Specialties. pp.158. ISBN:978-9928-05-164-6. 30-32 May 2014, Elbasan, Albania.

**27. Sihana Ahmeti Lika,** Merita Dauti, Edita Alili, Ledjan Malaj. Cost and safety analysis of Low Molecular Weight Heparine usage during pregnancy. First Macedonian and Fourth Adriatic Congress on Pharmacoeconomics and Outcomes Research- European Association for Clinical Pharmacology and Therapeutics, ISPOR-Republic of Macedonia Regional Chapter. pp.142-144. 24-27, April 2014, Ohrid, Macedonia.

**28.** Edita Alili Idrizi, **Sihana Ahmeti Lika,** Merita Dauti, Ledjan Malaj. Economic evaluation of antibiotic prescription in pediatrics. First Macedonian and Fourth Adriatic Congress on Pharmacoeconomics and Outcomes Research- European Association for Clinical Pharmacology and Therapeutics, ISPOR-Republic of Macedonia Regional Chapter. pp.100-102. 24-27, April 2014, Ohrid, Macedonia.

**29.** Merita Dauti, Edita Alili-Idrizi, **Sihana Ahmeti Lika,** Ledjan Malaj. Economic evaluation of antibiotic prescription in pediatrics. First Macedonian and Fourth Adriatic Congress on Pharmacoeconomics and Outcomes Research- European Association for Clinical Pharmacology and Therapeutics, ISPOR-Republic of Macedonia Regional Chapter. pp.136-138. 24-27, April 2014, Ohrid, Macedonia.

Në bazë të shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar komisioni recensues e konstatoi veprimtarinë shkencore-hulumtuese në periudhën paraprake, e cila është me rëndësi thelbësore për vlerësimin e kandidatës, i cili me kënaqësi konstaton se, nga shembulli i Dr.sc Sihana Ahmeti Lika, fitojmë një personalitet të mirëfilltë studiuesi dhe hulumtuesi shkencor nga fusha e farmacisë. Në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës (Buletini i universitetit), kandidatja Dr.sc.Sihana Ahmeti Lika ka realizuar gjithsej **142.4** pikë nga veprimtaria shkencore-hulumtuese.

#### **IV. Veprimtaria nga interesi më i gjerë**

Dr.sc. Sihana Ahmeti Lika ka ushtruar detyrën e Përgjegjëses së programit studimor Mjekësi e përgjithshme dhe Prodekanes për arsim të FSHM-së.

Ajo ka realizuar aktivitete edhe si anëtare e Komisionit për evaluim të brendshëm të Fakultetit të Shkencave Mjekësore.

Kandidatja është anëtare e bordit shkencor të revistës shkencore ndërkombëtare “ACTA MEDICA BALKANICA International Journal of Medical Sciences” të Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë të Universitetit të Tetovës.

Kandidatja është anëtare e bordit organizativ të Konferencës së Parë Ndërkombëtare Shkencore e Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë (ISCFMSC 2016), Konferencës së Dytë Ndërkombëtare Shkencore e Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë (ISCFMSC 2017), Konferencës së Tretë Ndërkombëtare Shkencore e Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë (ISCFMSC 2018) dhe Konferencës së Katërtë Ndërkombëtare Shkencore e Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë (ISCFMSC 2019).

Gjatë periudhës 2017-2020 ka qenë anëtare e komisionit për rangim të kandidatëve për studim në ciklin e parë dhe në vitin 2020 ka qenë anëtare komisioni për provimin pranues të studentëve të ciklit të parë, për programet studimore: Mjekësi e përgjithshme, Farmaci dhe Stomatologji.

Në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin Shtetëror të Tetovës (Buletini i universitetit), kandidatja Dr.sc. Sihana Ahmeti Lika ka realizuar gjithsej **16.0** pikë nga veprimtaritë me interes të gjërë për zgjedhjen në thirrjen docent.

#### **V. Veprimtari profesionale aplikative**

Kandidatja, në mënyrë aktive ka marrë pjesë në promovimin e ofertës akademike të Universitetit të Tetovës për vitet akademike 2017/18, 2018/19, 2019/20 dhe 2020/21 si dhe në organizimin e aktiviteteve të organizuara gjatë Ditëve të hapura, me qëllim promovimin e Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë.

Në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin Shtetëror të Tetovës (Buletini i universitetit), kandidatja Dr.sc. Sihana Ahmeti Lika ka realizuar gjithsej **8.0** pikë nga veprimtaritë profesionale aplikative për zgjedhjen në thirrjen docent.

## **VI. Formulari për raportin për zgjedhje në thirrjen mësimore-shkencore**

Në shtojcë e bashkëngjesim formularin për raportin e zgjedhjes në thirrjen mësimore-shkencore. Kandidatja Dr.Sc. Sihana Ahmeti Lika ka grumbulluar gjithsej **357.64** pikë, edhe atë për:

Veprimtarinë mësimore-arsimore – 191.24 pikë;

Veprimtarinë shkencore-hulumtuese – 142.4 pikë;

Veprimtaritë me interes më të gjerë – 16.0 pikë dhe

Veprimtarinë profesionale aplikative – 8 pikë.

<b>REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATES PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJE</b>	<b>Pikë</b>
VEPRIMTARIA MËSIMORE-SHKENCORE	191.24
VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE	142.4
VEPRIMTARI ME INTERES MË TË GJERË	16
VEPRIMATARI PROFESIONALE APLIKATIVE	8
<b>Gjithsej</b>	<b>357.64</b>

## VLERËSIM DHE PROPOZIMI

Në bazë të të dhënave që paraqitëm më lartë, vërtetohet se konstatimet tona janë mbështetur me dokumente dhe faktografi, dhe nga kjo mund të konstatojmë se kandidatja Dr.sc. Sihana Ahmeti Lika ka pasur angazhim në procesin e arsimimit të lartë në Universitetin e Tetovës dhe me këtë i plotëson në tërësi kushtet e parapara me konkurs. Punimet e saja shkencore, të botuara si referenca të veçanta në revista shkencore, dëshmojnë për profilin dhe gatishmërinë e saj që ndjek gjithmonë problematika aktuale në fushën e farmacisë. Puna e saj e deritanishme është e pasur me aktivitete konstruktive dhe flet për të arriturat e saj në procesin e afirmimit të marrëdhënieve kolegjiale, komunikimit kualitativ dhe bashkëpunimit në Fakultetin e Shkencave të Mjekësisë të Universitetit të Tetovës.

Prandaj, kemi nderin dhe kënaqësinë që Këshillit Mësimor Shkencor të Fakultetit të Shkencave Mjekësore t'i propozojmë që kandidatja Dr.sc. Sihana Ahmeti Lika të zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore DOCENT, për lëmitë: Bioteknologji, Teknologji farmaceutike dhe Farmakologji.

Besojmë se zgjedhja e saj do të kontribuojë në përparimin e arsimimit dhe proceseve kërkimore-shkencore në Programin studimor Farmaci në Universitetin e Tetovës.

Tetovë, 08.02.2022

### KOMISIONI RECENZUES:

1. **Prof. Dr. Dorentina Bexheti** – kryetar

---

2. **Prof. Dr. Bistra Angelovska** - anëtar

---

3. **Doc. Dr. Edita Alili Idrizi** – anëtar

---

## S H T O J C Ë

### PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE

**Kandidati:** Sihana Ahmeti Lika

**Institucioni:** Fakultet i Shkencave Mjekësore – UT Tetovë

**Lëmia shkencore:** Bioteknologji, Teknologji farmaceutike, Farmakologji

#### I. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Nr. Rend.	Emri i aktivitetit:	Pikët
<b>I.1</b>	<b>I.1 Mbajtja e ushtrimeve</b> (lëndë në ciklin e pare të studimeve)	<b>153</b>
	Kimi analitike 3+4, 1 semestër	$8 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 3.6$
	Botanikë farmaceutike 2+2, 2 semestra	$8 \times 15 \times 2 \times 0.03 = 7.2$
	Farmakognozi 3+5, 1 semesër	$10 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 4.5$
	Bazat e fitoterapisë 2+1, 2 semestra	$6 \times 15 \times 2 \times 0.03 = 5.4$
	anëtar i Akademisë Evropiane të Neurologjisë (EAN)	<b>1</b>
	anëtar i Federatës Botërore të Neurologjisë (WFN)	<b>1</b>
	anëtar i Komisionit në Odën e Mjekëve të Maqedonisë si ekzaminues i akredituar për kryerjen e provimit profesional për profesionistët shëndetësorë me arsim të lartë për marrjen e licencës së punës për periudhën 2017-2019.	<b>1</b>
	anëtar i Komisionit në Spitalin Klinik "Tetovë" në Tetovë për dhënien e mendimeve konsullore me konstatim për ushtrimin e të drejtës për ndihmë dhe përkujdesje nga një person tjetër	<b>1</b>
<b>IV.3</b>	<b>Qëndrim studimor deri 3 muaj</b>	
	Nga 08.06.2015 deri 04.07.2015, për diagnostikim të aksidentit vaskular cerebral iskemik dhe përdorim të trombolizës, Fakulteti i Mjekësisë në Universitetin e Lublanës, Republika e Sllovenisë	<b>1</b>
	Nga 17.03.2014 deri 30.05.2014, për përdorim të kolor dupleks sonografis ekstrakraniale në neurologji, Fakulteti i Mjekësisë në Universitetin e Stambollit, Republika e Turqisë	<b>1</b>
<b>IV.4</b>	<b>Trajnim edukativ nga:</b>	
	Kursi arsimor EAN, "EAN Regional Teaching Course", organizuar nga Klinika e Neurologjisë – Shkup nën kujdesin e Akademisë Evropiane të Neurologjisë, Strugë, 2018.	<b>1</b>
	Qëndrim dhe edukim profesional në fushën e neurologjisë dhe neurosonologjisë me trajnim individual për terapi trombolitike në fazën akute të infarktut iskemik në Klinikën e Neurologjisë, Departamenti i Neurologjisë Vaskulare dhe Terapisë Neurologjike Intensive, Qendra Klinike Universitare në Republikën e Sllovenisë, nga 09.06.2015 deri 03.07.2015.	<b>1</b>
	Qëndrim dhe edukim profesional në fushën e neurologjisë dhe neurosonologjisë me trajnim individual për sonografi me Doppler të arterieve karotide dhe vertebrale, nga 17.03.2014 deri 30.05.2014, Klinika e Neurologjisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Stambollit, Republika e Turqisë.	<b>1</b>
	Punëtori për "Terapinë trombolitike në fazën akute të infarktut iskemik" organizuar nga Klinika e Neurologjisë - Shkup nën patronatin e Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Maqedonisë, 27.08.2014.	<b>1</b>
	Kursi arsimor EFNS, "EFNS Rajonal Teaching Course", organizuar nga Klinika e Neurologjisë - Shkup nën mbështetjen e Federatës Evropiane të Shoqatave Neurologjike, Ohër, 2013.	<b>1</b>
	Pjesëmarrës në "Simpoziumin e parë për qelizat staminale dhe mjekësinë rigjeneruese me pjesëmarrje ndërkombëtare" organizuar nga Fakulteti i Mjekësisë Shkup, Fondacioni Kombëtar i Transplantit dhe Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Maqedonisë, Shkup, 23 mars 2011.	<b>1</b>
	Kursi edukativ "Trajtimi farmakologjik i epilepsisë", i udhëhequr nga	<b>1</b>

	Prof.Dr.Marija Kuturec dhe Prof.Dr.Gordana Kiteva-Trençevska organizuar për mjekë për kurrikulën për çertifikim evropian në epileptologji, Shkup, 2006.	
	Kurs edukativ tre mujor “Neurologjia urgjente”, organizuar nga Klinika e Neurologjisë në Fakultetin e Mjekësisë, Shkup, 2005.	1
	Simpoziumi shkencor "Amantadinsulfati në trajtimin e sëmundjes së Parkinsonit dhe çrregullimet e vigjilencës", organizuar nga Libra AG, Sofje, Republika e Bullgarisë, 2004.	1
	Kursi edukativ “Njohuritë themelore për diagnozën klinike dhe menaxhimin e krizave dhe epilepsisë”, udhëhequr nga Prof.Dr.Marija Kuturec dhe Prof.Dr.Gordana Kiteva-Trençevska dhe të organizuar për mjekë për kurrikulën për çertifikim evropian në epileptologji, Shkup, 2004.	1
	Kursi edukativ "Shëndeti publik me bazë dëshmish, statistikat shëndetësore, raportimi shëndetësor dhe epidemiologjia klinike", organizuar nga Universiteti i Tetovës, i udhëhequr nga Prof. Dr. Doris Bardehle (Universiteti i Bielefeld, Gjermani), Prof. Dr. Nexhbedin Beadini (Universiteti i Tetovës, Maqedoni) dhe Prof. Dr. Enver Roshi (Universiteti i Tiranës, Shqipëri), Tetovë, 2004.	1
	Projekti edukativ për menaxhimin e sektorit shëndetësor në kuadër të "Programit të akredituar të trajnimit për trajnerë kyç (edukatorë, ekzaminues dhe mentorë) për modernizimin e procesit të licencimit të mjekëve, stomatologëve dhe farmacistëve të Republikës së Maqedonisë" në qershor dhe shtator të vitit 2006, përmes prezencës dhe të vlerësimit nga trajnues profesorë eminent (Xhudi Mekkim dhe Anita Andervud), mbështetur nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Maqedonisë dhe i certifikuar si ekzaminues	1
	Kurs edukativ “Reanimacion kardiak, pulmonar dhe cerebral”, organizuar nga Klinika për anestezi, reanimacion dhe kujdes intensiv në Fakultetin e Mjekësisë Shkup, 1994.	1
	Qëndrim profesional dhe edukim në fushën e mjekësisë tradicionale me trajnim individual në Universitetin e Hapur Ndërkombëtar për Mjekësi Alternative në Colombo - Sri Lanka nga nëntori 1992 deri në janar 1993, duke marrë kështu titullin Doktor i Mjekësisë Tradicionale.	1
	Seminar një mujor me trajnime individuale në fushën e akupunkturës dhe moxibustion, shkalla II (kurs i avancuar) organizuar nga Instituti i Akupunkturës në Sarajevë të Bosnjë dhe Hercegovinës, nga Shoqëria për Mjekësi Tradicionale "Belladonna" nën mbështetje të WFAS-së (Federata Botërore e Akupunkturës dhe Moxibustionit) në OBSH dhe Qendrës Ndërkombëtare të Akupunkturës të Akademisë së Mjekësisë Tradicionale të Pekinit, Sarajevë, RSF e Jugosllavisë, qershor 1991.	1
<b>IV.5</b>	<b>Certifikatë për të arritura shkencore-profesionale</b>	
	Në vitin 2015, certifikatë (Nr: 111/121-2015) për terapi trombolitike në fazën akute të infarktit iskemik nga Klinika e Neurologjisë, Departamenti i Neurologjisë Vaskulare dhe Terapisë Neurologjike Intensive, Qendra Klinike Universitare në Republikën e Sllovenisë.	3
	Në vitin 2014, certifikatë për sonografi me Doppler të arterieve karotide	3

	dhe vertebrale, nga Klinika e Neurologjisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Stambollit, Republika e Turqisë.	
	Në vitin 2006 i avansuar në thirrjen primarius me vendim (Nr: 08-5075) të komisionit për ndarjen e thirrjes primarius nga ministria e shëndetësisë e Republikës së Maqedonisë.	<b>3</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>IV.1+IV.2+IV.3+IV.4+IV.5</b>	<b>42</b>

<b>REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN DOCENT</b>	<b>Pikët</b>
<b>VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE</b>	<b>56.42</b>
<b>VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE</b>	<b>181.5</b>
<b>VEPRIMTARITË PROFESIONALE-APLIKATIVE</b>	<b>9</b>
<b>VEPRIMTARITË ME INTERES MË TË GJËRË</b>	<b>42</b>
<b>GJITHSEJ</b>	<b>288.92</b>

**Deri te:**  
**KËSHILLI MËSIMOR-SHKENCOR I**  
**FAKULTETIT TË SHKENCAVE MJEKËSORE**  
**UNIVERSITETI I TETOVËS**

**R E F E R A T**

**PËR ZGJEDHJEN E NJË MËSIMDHËNËSI NË FAKULTETIN E SHKENCAVE**  
**MJEKËSORE NË UNIVERSITETIN E TETOVËS**

Në pajtim me nenin 110 dhe 173 të Ligjit të Arsimit të Lartë (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 82/2018), nenit 252 dhe 254 të Statutit të Universitetit të Tetovës, me Vendim të Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Shkencave Mjekësore të Universitetit të Tetovës te mbajtur me 02.02.2022, nr. 22-188/1 të datës 04.02.2022, në lidhje me Konkursin e shpallur më 25.12.2021 në gazetata ditore „Koha“ dhe „Sloboden Peçat“ si dhe në web faqen e Universitetit [www.unite.edu.mk](http://www.unite.edu.mk), për zgjedhje/rizgjedhje të një mësimitdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin Kirurgji Digjesticive (30306 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në programin studimor Mjekësi e Përgjithshme, u zgjodh unanimitisht Komisionin recensues në këtë përbërje: .

1. **Prof.Dr. Zoran Spirovski (kryetar)** - profesor ordinar në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti Shën Kirili dhe Metodi.
2. **Prof.Dr. Omer Xhemali (anëtar)** - profesor ordinar në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Tetovës, Tetovë
3. **Prof.Dr. Nevzat Elezi (anëtar)** - profesor ordinar në Fakultetin e Shkencave Mjekësore, Universiteti i Tetovës, Tetovë.

Komisioni i lartëpërmendur pasi që i pranoi materialin e dorëzuar në konkurs, titullit të lartëpërmendur i paraqet këtë:

**RAPORT**

Me datë 25.12.2021 në gazetën ditore “Koha” dhe “Sloboden Peçat” është shpallur konkurs për zgjedhje të një mësimitdhënësinë Fakultetin e Shkencave Mjekësore për lëndët mësimore: KIRURGJI DIGJESTIVE 30306 SIPAS FRASKAT.

Komisioni në fjalë, pasi kontrollon materialet e dorëzuar, konstatoi se në konkurs është paraqitur një kandidat, edhe atë:

1. **Doc. Dr Florim Selimi**

## **TË DHËNAT BIOGRAFIKE DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL**

### **BIOGRAFIA**

(Curriculum vitae)

Dr. Florim Selimi, specialist i Kirurgjisë së përgjithshme, PHD

I lindur me 17.04.1970

Çelopek 1227, Bërvenicë, Tetovë

Tel.044 458-704

Tel.070 775 216

E-mail:fselimi\_dr@yahoo.com

#### **Edukimi:**

2014-2016 Univerziteti I mjekësisë Plovdiv, Rep.e Bullgarisë-studimet e doktoranturës, PHD

1997-2002 Qendra klinike Shkup-specializim në kirurgjinë e përgjithshme

1989-1995 Univerziteti I mjekësisë Sofje, Rep.e Bullgarisë, studimet univerzitare në fakultetin e mjekësisë.

1984-1988 Shkolla e mesme, gjimnazi Kiril Pejçinoviç-Tetovë

1977-1984. Shkolla fillore Bratstvo, fshati Çelopek

#### **Përvoja në punë profesionale:**

2014-2021 Kryeshef I repartit të kirurgjisë viscerale, Spitali klinik Tetovë.

2002-2021 Specialist I kirurgjisë së përgjithshme, Spitali klinik Tetovë,

1997-2002 Specializim në kirurgjinë e përgjithshme, Qendra klinike Shkup.

1997 Mjek sekondar, Qendra spitalore medicinale Tetovë.

#### **Angazhimi akademik në fakultetin e shkencave të mjekësisë pranë UT:**

2017-2021. Ligjërues në lëminë e Kirurgjisë I, II

2017. Thirrje DOCENT



2012-2021. Asistent në lëminë e Kirurgjisë I, II

Njohje pune me PC (MSoffice-Word, excel, power point....)

Njohje e gjuhëve të huaja:

Anglisht-rjedhshëm shkrim e lexim,

Bullgarisht-rjedhshëm shkrim e lexim,

Sërbokroatisht-rjedhshëm. shkrim e lexim

Maqedonisht-rjedhshëm shkrim e lexim

### **VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE**

Doc.Dr.Florim Selimi në kuadër të veprimtarisë mësimore-arsimore pranë Fakultetit të Shkencave Mjekësore në Universitetin e Tetovës mban ligjërata në lëndët:

Kirurgji 1,2

Prevenca e infeksioneve intrahospitalore

Prevenca e infeksioneve ne blokun kirurgjik

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës (Buletini i Universitetit), kandidati Doc .Dr. Florim Selimi realizuar gjithsej 136.9 pikë nga veprimtaria mësimore-arsimore.

### **VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE**

Krahas angazhimit në procesin mësimor, kandidati është marrë me hulumtime shkencore në fushën e shkencave të mjekësisë.

Veprimtaria shkencore-hulumtuese e kandidatit përbëhet nga artikuj shkencorë të botuar në revista shkencore ndërkombëtare, me pjesëmarrje në tubime shkencore.

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës (Buletini i Universitetit), kandidati Doc.Dr. Florim Selimi ka realizuar gjithsej 18.4 pikë nga veprimtaria shkencore-hulumtuese

## **VEPRIMTARIA PROFESIONALE - APLIKATIVE**

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës (Buletini i Universitetit), kandidati Doc .Dr. Florim Selimi në këtë veprimtari ka grumbulluar 8 pikë.

## **VEPRIMTARIA NGA INTERESI MË I GJËRË**

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës (Buletini i Universitetit), kandidati Doc .Dr. Florim Selimi në këtë veprimtari ka grumbulluar 43 pikë.

## **FORMULARI PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJE NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE**

Në shtojcat e mëposhtme është bashkangjitur formulari për raportin e zgjedhjes në thirrjen mësimore-shkencore. Kandidati Doc .Dr. florim Selimi ka grumbulluar gjithsej 206.3 pikë, edhe atë për: veprimtarinë mësimore-arsimore 136.9 pikë , veprimtarinë shkencore-hulumtuese 18.4 pikë, veprimtarinë profesionale-aplikative 8 pikë dhe veprimtarinë me interes më të gjerë 43 pikë.

<b>REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJE</b>	<b>PIKË</b>
VEPRIMTARIA MËSIMORE-SHKENCORE	136.9
VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE	18.4
VEPRIMTARIA PROFESIONALE - APLIKATIVE	8
VEPRIMTARIA ME INTERES TË GJËRË	43
<b>GJITHSEJ</b>	<b>206.3</b>

## PËRFUNDIMI DHE PROPOZIMI

Në bazë të pasqyrës së prezantuar më lartë, si dhe nga të dhënat në shtojcë, Komisioni Recensues i vlerëson pozitivisht aktivitetet në veprimtaritë mësimore-arsimore, shkencore-hulumtuese dhe veprimtarinë me interes më të gjerë dhe konstaton se kandidati Doc.Dr.Florim Selimi, Docent në Fakultetin e Shkencave Mjekësore, në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore-mësimore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkë-punëtorit në Universitetin e Tetovës, ka grumbulluar gjithsej 206.3 pikë nga referencat profesionale, me këtë e ka tejkaluar numrin minimal të pikëve që duhet të realizohen, për zgjedhjen në thirrjen mësimore-shkencore: PROFESOR INORDINAR.

Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme për aktivitetin e përgjithshëm të kandidatit, Komisioni Recensues konstaton se: Doc.Dr.Florim Selimi posedon cilësi të larta shkencore-profesionale dhe në bazë të nenit 172 të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 82/2018), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës dhe nenin 166 të Ligjit për arsimin e lartë, i plotëson të gjitha kushtet për t'u zgjedhë në thirrjen që ka konkurruar (Profesor InOrdinar).

Komisioni Recensues ka nderin dhe kënaqësinë e veçant t'i propozojë Këshillit Mësimor-Shkencor dhe Fakultetit të shkencave mjekësore dhe Senatit të Universitetit të Tetovës, që kandidati Doc. Dr Florim selimi të zgjidhet në thirrjen mësimore shkencore PROFESOR INORDINAR për lëndët mësimore: KIRURGJI DIGJESTIVE 30306 SIPAS FRASKAT

Komision Recenzues

1. Prof. Dr. Zoran Spirovski – Kryetar

---

2. Prof. Dr. Omer Xhemali – Anëtar

---

3. Prof. Dr. Nevzat Elezi – Anëtar

---

## SH T O J C Ë

### PËR RAPORTIN E ZGJEDHJES NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE

**Kandidati:** Florim Selimi

**Institucioni:** Fakulteti i Shkencave Mjekësore - Universiteti i Tetovës, Tetovë

**Lëmia shkencore:** Shkencat Mjekesore

### VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Nr.	Emri i aktivitetit	Kalkulimi	Pikët
<b>1</b>	<b>Mbajtja e ligjëratave në ciklin e parë të studimeve</b>		<b>114</b>
1.1	Prevenca e infeksioneve intrahospitalore	1x15x0.04x5	3
1.2	Prevenca e infeksioneve në bllokun kirurgjik	1x15x0.04x5	3
1.3	Kirurgji I	8x15x0.04x5	24
1.4	Kirurgji II	12x15x0.04x5	36
1.5	Kirurgji I praktikë	8x15x0.04x5	24
1.6	Kirurgji II praktikë	8x15x0.04x5	24
<b>2</b>	<b>Mentor për mbrojtjen e temës në ciklin e parë</b>	30x0.2	<b>4</b>
<b>3</b>	Skriptë interne për ligjërime		<b>16</b>
3.1	Praktikum i Kirurgjisë (Infermieri)	4	4
3.2	Praktikum i Kirurgjisë (Mjekësi dhe Stomatologji)	4	4
3.3	Praktikum i infeksioneve intrahospitale(Fizioterapi)	4	4
3.4	Praktikum i infeksioneve në bllokun kirurgjik(Infermieri)	4	4
<b>4</b>	Konsultime me studentë		<b>2.9</b>
4.1	Prevenca e infeksioneve intrahospitale(Fizioterapi)	50x2x0.002	0.2
4.2	Prevenca e infeksioneve në bllokun kirurgjik(Infermieri)	70x3x0.002	0.42
4.3	Instrumentet kirurgjike (Infermieri)	70x3x0.002	0.42
4.4	Kirurgji e përgjithshme (Infermieri dhe Fizioterapi)	120x2x0.002	0.48
4.5	Kirurgji e përgjithshme (Stomatologji)	80x6x0.002	0.96
4.6	Kirurgji e përgjithshme (Mjekësi)	70x3x0.002	0.42
	<b>Totali i pikëve nga veprimtaria mësimore-arsimore</b>		<b>136.9</b>

## VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Nr.	Emri i aktivitetit	Pikët
<b>1</b>	<b>Teza të mbrojtura</b>	
1.1	Teza e Doktoraturës: “Faktorët prognostik dhe mbijetesa tek pacientët me karcinom të lukthit” Universiteti i Mjekësisë, 2016, Plovdiv, Bullgari	/
<b>2</b>	<b>Punim me rezultate origjinale shkencore, të botuar në revistë referente shkencore/profesionale me bord editorial ndërkombëtar</b>	<b>7.2</b>
2.1	Universi, volume 03, issue 01, december 2017 Predicting the clinical outcome and the need for therapeutic intervention in patients with acute upper non variceal gastrointestinal bleeding using the Glasgoww blatchford scale	3.6
2.2	Second international conference of faculty of medical sciences Amyands hernia a report of two cases	3.6
<b>4</b>	<b>Pjesëmarrje në takim shkencor/profesional me referat - prezentim oral</b>	<b>2</b>
4.1	Second international conference of faculty of medical sciences	2
<b>Totali i pikëve nga veprimtaria shkencore - hulumtuese</b>		<b>18.4</b>

## VEPRIMTARIA PROFESIONALE – APLIKATIVE

Nr.	Emri i aktivitetit:	Pikët
<b>1</b>	<b>Pjesëmarrje në aktivitetet promovuese të fakultetit/institucionit</b>	<b>2</b>
1.1	Prezantimi i ofertës akademike të Universitetit të Tetovës në shkollat e mesme në vitin akademik 2016/2017	1
1.2	Prezantimi i ofertës akademike të Universitetit të Tetovës në shkollat e mesme në vitin akademik 2018/2019	1
<b>2</b>	<b>Përfundim i specializimit në fushën e shkencave mjekësore dhe shëndetësore</b>	<b>2</b>
2.1	Specialist i Kirurgjis.	2
<b>Totali i pikëve nga veprimtaria profesionale - aplikative</b>		<b>8</b>

## VEPRIMTARIA ME INTERES TË GJËRË

Nr.	Emri i aktivitetit	Pikët
<b>1</b>	<b>Këshilli redaktues I revistës shkencore/profesionale ndërkombëtare</b>	<b>9</b>
1.3	“Medicus”, botim i Shoqatës së Mjekëve Shqiptarë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.	3
<b>2</b>	<b>Kryetari i bordit organizativ ose programor të një takimi shkencor / profesional ndërkombëtar</b>	<b>8</b>
2.1	Konferenca e parë shkencore ndërkombëtare “Contemporary trends of medical sciences and the development dynamics of modern medicine”, Fakulteti I Shkencave Mjekësore, UT, 3 – 4 Qershor 2016	2
2.2	Konferenca e dytë shkencore ndërkombëtare “Healthcare challenges of the 21st century”, Fakulteti I Shkencave Mjekësore, UT, 13-14 Tetor 2017	2
2.3	Konferenca e tretë shkencore ndërkombëtare, Fakulteti I Shkencave Mjekësore, Universiteti i Tetovës, 8 – 10 Nëntor 2018	2
2.4	Konferenca e katërt shkencore ndërkombëtare, Fakulteti I Shkencave Mjekësore, Universiteti i Tetovës, 15 – 17 Maj 2019	2
<b>3</b>	<b>Pozitë udhëheqëse</b>	<b>14</b>
3.1	Shef I Departamentit Kirurgji	6
3.2	Kryetar I komisionit per nostrifikim te diplomave	4
3.3	Kryetar I komisionit per vleresim te aftesise se punes	4
<b>5</b>	<b>Anëtar komisioni për zgjedhje në thirrje shkencore bashkëpunëtorët dhe mësimdhënësit</b>	<b>12</b>
5.1	Anëtar komisioni për zgjedhje në tituj të bashkëpunëtorëve dhe mësimdhënësve.	12
<b>Totali i pikëve nga veprimtaria me interes të gjërë</b>		<b>43</b>

### Komision Recenzues

1. Prof. Dr. Zoran Spirovski – Kryetar

\_\_\_\_\_

2. Prof. Dr. Omer Xhemali – Anëtar

\_\_\_\_\_

3. Prof. Dr. Nevzat Elezi – Anëtar

\_\_\_\_\_

# R E F E R A T

## **PËR ZGJEDHJEN E MËSIMDHËNËSIT NË TË GJITHË TITUJT MËSIMORE-SHKENCORE NË LËMINË GJINEKOLOGJI DHE AKUSHERI (30205 NGA KLASIFIKIMI I SFERAVE, FUSHAVE DHE LËMENJVE SHKENCORË-HULUMTUES SIPAS KLASIFIKIMIT NDËRKOMBËTAR TË FRASKATIT), NË FAKULTETIN E SHKENCAVE MJEKSORE – UNIVERSITETI I TETOVËS, TETOVË**

Në bazë të nenit 172 të Ligjit për Arsimin e Lartë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 82/2018,,), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, si dhe në bazë të Propozimit të këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit të Shkencave Mjekësore, në lidhje me konkursin për zgjedhje – rizgjedhje të mësimdhënësve në Universitetin e Tetovës të shpallur me datë 25.12.2021 në gazetën ditore “Koha” dhe “Sloboden Peçat”, si dhe në web-faqen e Universitetit të Tetovës [www.unite.edu.mk](http://www.unite.edu.mk), Këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit të Shkencave Mjekësore, UT-Tetovë në mbledhjen e mbajtur më 02.02.2022 solli Vendimin me Nr. 22-188/1, me datë 04.02.2022 për formimin e komisionit recensues për zgjedhjen-rizgjedhjen e një mësimdhënësi në lëmin **Gjinekologji dhe Akusher** (30205 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmive shkencorë hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në përbërje:

- 1. Prof. Dr.Sadi Bexheti (kryetar)** - profesor ordinar në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Tetovës
- 2. Prof. Dr. Goran Dimitrov (anëtar)** - profesor inordinar në Fakultetin e Shkencave Mjekësisë, Universiteti "Shën Kirili dhe Metodij", Shkup
- 3. Prof. Dr. Gligor Tofoski (anëtar)** - profesor inordinar në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti "Shën Kirili dhe Metodij", Shkup

Në konkursin e shpallur për zgjedhje-rizgjedhje të mësimdhënësit në të gjithë titujt mësimore-shkencore në afatin e paraparë është paraqitur kandidati:

**D-r. sc. Florin Besimi Dr. spec.**

Pas shqyrtimit të materialeve (dokumenteve) të dorëzuara, komisioni recensues ka nderin që Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit të Shkencave Mjekësore – Universiteti i Tetovës - Tetovë, t’ia paraqesë këtë:

# R A P O R T

Në konkursin e shpallur për zgjedhjen e një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore -shkencore në lëminë **Gjinekologji dhe Akushi** (30205 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmive shkencorë hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në afat të parashikuar është paraqitur kandidati:

**D-r. sc. Florin Besimi Dr. spec.**

Kandidati **D-r. sc. Florin Besimi Dr. spec.**, ka dorëzuar dokumentacionin e kompletuar të paraparë në konkurs.

## 1.TË DHËNA BIOGRAFIKE DHE ARSIMIMI

### **FLORIN Islam BESIMI**

#### SHKOLLIMI DHE EDUKIMI

- 1987, Shkolla fillore e muzikës, Tetovë
- 1988, Shkolla Fillore “Istigball”, Tetovë
- 1992, Shkolla e Mesme Komunale e Mjekësisë “Nikolla Shtejn”, Tetovë
- 2000, Fakulteti i Mjekësisë, Shkup
- 2008, Specijalist i gjinekologjisë dhe obstetrikës, Fakulteti i Mjekësisë, Shkup
- 2008, Licencim për Menaxher dhe Lider i institucioneve shëndetësore
- 2010, Regjistrim në studimet e Doktoraturës pranë Fakultetit të Mjekësisë në Tiranë, R. e Shqipërisë
- 2012, Edukim, provim, Çertifikatë për Drejtor të institucioneve shëndetësore
- 2012, Edukim, provim, Çertifikatë për furnizime publike
- 2013, Certificate of Completion “ Health Care Economics, Systems and Policies Seminar”  
The University of Sheffield
- 2013, Certificate of Completion “ Organizational Behaviour” The University of Sheffield,  
City College An International Faculty of The University Sheffield, City College An In
- 2014, Certificate of Completion “Change Management” The University of Sheffield, City  
College An International Faculty of The University ternational Faculty of The University
- 2014, Certificate of Completion “Logistics and Supply Chain Management” The  
University of Sheffield, City College An International Faculty of The University
- 2015, Fiton titullin Primarius nga Ministria e Shëndetësisë
- 2015, Doktor i Shkencave të Mjekësisë – në fushën e Gjinekologjisë dhe Obstetrikës,  
Fakulteti i Mjekësisë Tiranë
- 2016, Licencë për ekspertizë gjyqësore në fushën e gjinekologjisës me obstetrikë,  
Ministria e Drejtësisë, R. Maqedonisë
- 2017, Zgjidhet në thirrjen mësimore – shkencore Docent për lëndët në fushën e  
gjinekologjisë dhe obstetrikës, Fakultetin e Shkencave Mjekësore në Universitetin e Tetovës.



## **2. ARRITJET SHKENCORE, PROFESIONALE, PEDAGOGJIKE SI DHE ARRITJET E TJERA TË KANDIDATIT, QË NGA ZGJEDHJA E FUNDIT DERI NË DITËN E PARAQITJES**

### **Veprimtaria shkencore-arsimore**

Në kuadër të veprimtarisë mësimore-arsimore pranë Fakultetit të Shkencave Mjekësore në Universitetin e Tetovës, kandidati **D-r. sc. Florin Besimi D-r. spec.** mban mësim praktik dhe teorik (mësimdhënie, ushtrime, mësimdhënie në terren, etj.) në ciklin e parë të studimeve në të gjithë programet studimore në Fakultetin e Shkencave Mjekësore. Është mentor i shumë temave të diplomës si dhe mentor i temave studentore të prezantuara në kongreset studentore të Republikës dhe një numër i madh praktikantësh të cilët e kanë kryer praktikën. Në viti 2017 zgjidhet në thirrjen shkencore **docent** në Fakultetin e Shkencave Mjekësore, Universiteti i Tetovës. Nga angazhimi në UT si docent, në mënyrë aktive punon për edukimin e studentëve të Fakultetit të Shkencave Mjekësore, duke kryer ligjërata dhe ushtrime në lëndët:

- **Gjinekologji I (Mjekësi e përgjithshme),**
- **Gjinekologji II (Mjekësi e përgjithshme),**
- **Gjinekologji (Stomatologji),**
- **Gjinekologji me akusheri me kujdes (Infermieri),**
- **Gjinekologji me kujdes (Akusheri),**
- **Gjinekologji (Praktika),**
- **Akusheri me kujdes I (Akusheri),**
- **Akusheri me kujdes II (Akusheri),**
- **Akusheri me kujdes III (Akusheri),**
- **Udhëheqja e lindjes (Akusheri)**

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen-rizgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës (Buletini i Universitetit), kandidati **D-r. sc. Florin Besimi Dr. spec.** në këtë veprimtari mësimore-arsimore ka një sere aktivitete të cilat janë prezantuar në formularin e tabelave me pike.

## Veprimtaria shkencore-kërkimore/veprimtaria profesionale-artistike

Krahas angazhimit në procesin mësimor, kandidati është marrë me hulumtime shkencore në fushën e shkencave të mjekësisë

Veprimtaria shkencore-hulumtuese e kandidatit përbëhet nga artikuj shkencorë të botuar në revista shkencore ndërkombëtare, me pjesëmarrje në tubime shkencore.

**Për konkursin aktual i ka paraqitur punimet vijues për recension:**  
Punime shkencore me rezultate origjinale shkencore, të botuara në revista shkencore me këshill drejtues ndërkombëtar:

### *DEPRESIONI POSTPARTAL DHE MULTIPOLARITETI*

*Florin Besimi et al. Medicus 2018, Vol.23 (3):244-247*

### *INFEKSIONET GJENITALE DHE URINARE SI SHKAK I VIZITAVE TE SHPESHTA NE REPARTIN E GJINEKOLOGJISE*

*Florin Besimi et al. Medicus 2019, Vol. 24 (3):350-3*

### *TREATMENT CORRELATION OF SIDEROPENIC ANEMIA WITH IRON (III) PROTEIN SUCCINYLA TE (IPS) AND SUCROMIAL IRON (SI)*

*Florin Besimi et al. Acta Medica Balkanica. Vol. 4, issue 7-8, pg 133-13*

### *KORELACIONI I TRAJTIMIT TE ANEMISE SIDEROPENIKE ME HEKUR (III) PROTEIN SUCCINILATE DHE ME FEROSUCCROSOMAL*

*Florin Besimi et al. Medicus 61, Vol. 23 (3) December 2018*

### *HOSPITAL BASED STUDY OF MATERNAL, PERINATAL AND NEONATAL OUTCOMES IN ADOLESCENT PREGNANCY COMPARED TO ADULT WOMEN PREGNANCY*

*Florin Besimi et al. Open acces macedonian journal of medical sciences, Vol.7, issue 5, pg. 760*

### *PRIMARY FALLOPIAN TUBE CARCINOMA: A CASE REPORT AND LITERATURE REVIEW*

*Florin Besimi et al. Open acces macedonian journal of medical sciences, Vol. 5, issue 3, pg. 344.*

### *GIANT FIBROEPITHELIAL POLYP OF VULVA: A CASE REPORT AND REVIEW OF LITERATURE*

*Florin Besimi et al. Open acces macedonian journal of medical sciences, Vol. 39, issue 2-3, pg. 127-130*

### **3.VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE DHE VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJERË**

Kandidati **D-r. sc. Florin Besimi Dr. spec.** është i përfshirë në mënyrë aktive në punimet seminarike, kurseve edukative dhe kurseve në takime profesionale dhe seksionesh. Poashtu në këtë veprimtari ka një sërë aktivitetesh dhe procese profesionale-aplikative, të cilat janë prezantuar në formularin e tabelave me pikë.

Aktivitet të veçantë kandidati tregon në veprimtaritë me interes më të gjerë:

Drejtor i Spitalit klinik Tetovë

Primarius

Anëtar i këshillit shkencor të konferencave ndërkombëtare

Anëtar i këshillit botues të revistës ACTA MEDICA të UT.

Anëtar i këshillit shkencor të revistës ACTA MEDICA të UT

Anëtar i komisioneve me rastin e mbrojtjes së punimit të diplomës në FSHM në UT

Mentor i mbrojtjes të punimeve të diplomës në FSHM të UT.

Konsulent i UNFPA

Pjesëmarës i projekteve të Fondit për popullatë i Kombeve të Bashkuara, prej vitit 2018, në planifikimin dhe implementimin të aktiviteteve nga Programi e UNFPA 2016-2020

Partneriteti i UNFPA me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë dhe Ministrinë e Shëndetësisë për uljen e vdekshmërisë amtare dhe neonatale (2018), bashkëpunim ky që vetëm brenda një vitit vdekshmërinë neonatale e uli më shumë se një të tretën. D-r. Besimi është marrë me projektimin dhe kryerjen e trajnimeve, për kujdesin efektiv perinatal, veçanërisht për pjesën që iu referua Spitalit klinik në Tetovë. Me këtë trajnim, ekipet multidisciplinore nga gjinekolog/obstetër, neonatolog dhe mami u trajnuan sipas protokoleve dhe standardeve të Organizatës Botërore Shëndetësore

Monitorimi i maternitetit për zbatimin e rekomandimeve dhe procedurave të prezantuara me trajnimin për kujdes efektiv perinatal, me qëllim promovimin e shëndetit të nënës dhe të porsalindurit (2019).

Kontribut në nismën për vlerësim të shpejtë të materniteteve për nevojat për pajisje të mbrojtjes personale , si pasoj nga KOVID-19 (2020).

Anëtar i delegacionit kombëtar të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Punëtorinë e vendeve nga Ballkani për përmirësimin e cilësisë së shëndetit të nënës dhe të porsalindurve bazuar në zbatimin e rekomandimeve që dalin nga rishikimi i komplikimeve të rënda nga shëndeti i nënës, mbajtur në Bukuresht, Rumani, 28-29 nëntor 2018.

Hartimi i një broshure për të rritur ndërgjegjshmërinë e grave dhe familjeve të tyre për

shenjat e rrezikut gjatë shtatzënisë dhe lindjes, (2018).

Krijimi dhe futja e një sistemi kombëtar për mbikëqyrjen dhe reagimin në obstetrikë, si pjesë iniciuar nga vendet e Ballkanit Perëndimor, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për shëndetin e nënës (2019-2020).

Kontributi në standardet e gjinekologjisë dhe obstetrikës për kushtet spitalore dhe jashtë spitalore mbrenda aktiviteteve të Agjencisë për cilësi dhe akreditim të institucioneve shëndetësore (2018).

Anëtar i Trupit Koordinues të Projektit të Përbashkët të OKB-së "Shërbime shëndetësore të Sigurta dhe Inovative" në mes tre agjencive të OKB-së, UNFPA, UNICEF dhe OBSH. Kontribut të veçantë Doc. Dr. Besimi dha për caktimin e shërbimeve mobile për gjinekologji dhe obstetrikë me qëllim përmirësimin dhe parandalimin e kancerit të qafës së mitrës në kushtet e pandemisë KOVID, me fokus të veçantë në gratë dhe vajzat më të cënuara.

## KONKLUDIM DHE PROPOZIM

Duke u bazuar në tërë dokumentacionin e paraqitur dhe duke e analizuar veprimtarinë e deritanishme të përgjithshme të kandidatit nga gjitha e thëna më sipër, mund të shihet qartë vija e lartë e ngritjes të zhvillimit profesional të kandidatit **D-r. sc. Florin Besimi Dr. Spec**, komisioni recenzues e çmon pozitivisht dhe e vlerëson veprimtarinë mësimore-arsimore, kërkimore-shkencore dhe profesionale-aplikative, si dhe veprimtarinë me interes më të gjerë. Në bazë të dhënave të paraqitura të veprimtarisë së përgjithshme të kandidatit, Komisioni konkludoi se **D-r. sc. Florin Besimi Dr. spec.** posedon cilësi shkencore dhe profesionale dhe sipas Ligjit për arsim të lartë dhe Rregullores për kriteret dhe për procedurën e zgjedhjes në tituj mësimorë-shkencorë, shkencorë, mësimorë-profesionalë dhe në tituj bashkëpunëtorë të Universitetit të Tetovës, i plotëson të gjitha kushtet që të zgjidhet në titullin **profesor inordinarnë** lëminë e **Gjinekologji dhe Akushi** (30205 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmime shkencorë hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)

Sipas kësaj që u tha më lartë, Komisioni ka nderin dhe kënaqësinë t'i propozojë Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Shkencave Mjekësore, pranë Universitetit të Tetovës, **Dr. sc. Florin Besimi D-r. spec.** të zgjidhet në titullin **profesor inordinarnë** lëminë e **Gjinekologji dhe Akushi** (30205 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmime shkencore hulumtuese sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)

07.02.2022, Tetovë

## KOMISIONI I RECENSENTËVE

1. **Prof. Dr.Sadi Bexheti (kryetar)** - profesor ordinar në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Tetovës

---

2. **Prof. Dr. Goran Dimitrov (anëtar)** - profesor inordinar në Fakultetin e Shkencave Mjekësisë, Universiteti "Shën Kirili dhe Metodij", Shkup

---

3. **Prof. Dr. Gligor Tofoski (anëtar)** - profesor inordinar në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti "Shën Kirili dhe Metodij", Shkup

---

# FORMULAR – I APLIKIMIT

## TË RAPORTIT PËR ZGJEDHJEN NË TITULL MËSIMOR -SHKENCOR, SHKENCOR, MËSIMOR-PROFESIONAL DHE BASHKËPUNËTOR

Kandidati: **FLORIN Islam BESIMI.**

Institucioni: **UT-Tetovë, FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE – Tetovë**

Lëmia shkencore: **Gjinekologji dhe Akusheri**(30205 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmive shkencorë hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)

### VEPRIMTARIA MËSIMORE -ARSIMORE

Nr. rend	EMËRTIMI I VEPRIMTARISË	Pikë
<b>1.</b>	<b>Mbajtja ligjërata dhe ushtrimeve (laboratorike, klinike, auditoriale ose <u>përpilim i punimit seminarik</u>)</b>	<b>93.00</b>
1.1	Gjinekologji I (Mjekësi e përgjithshme) 3x15x0.04x5	9
1.2	Gjinekologji II (Mjekësi e përgjithshme) 3x15x0.04x5	9
1.3	Gjinekologji (Stomatologji) 1x15x0.04x5	3
1.4	Gjinekologji me akusheri me kujdes (Infermieri) 3x15x0.04x5	9
1.5	Gjinekologji me kujdes (Akusheri) 3x15x0.04x5	9
1.6	Gjinekologji(praktika) 6x15x0.04x5	18
1.7	Akusheri me kujdes I (Akusheri) 3x15x0.04x5	9
1.8	Akusheri me kujdes II (Akusheri) 3x15x0.04x5	9
1.9	Akusheri me kujdes III (Akusheri) 3x15x0.04x5	9
1.10	Udhëheqja e lindjes (Akusheri) 3x15x0.04x5	9
<b>2.</b>	<b>Konsultime me studentë</b>	<b>7.00</b>
2.1	Gjinekologji I (Mjekësi e përgjithshme) 0.002x5vjete x100 student	1
2.2	Gjinekologji II (Mjekësi e përgjithshme) 0.002x5 x100	1
2.3	Gjinekologji (Stomatologji) 0.002x5 x50	0.50
2.4	Gjinekologji me akusheri me kujdes (Infermieri) 0.002x5 x50	0.50
2.5	Gjinekologji me kujdes (Akusheri) 0.002x5 x50	0.50
2.6	Gjinekologji(praktika) 0.002x5 x100	1
2.7	Akusheri me kujdes I (Akusheri) 0.002x5 x50	0.50
2.8	Akusheri me kujdes II (Akusheri) 0.002x5 x50	0.50
2.9	Akusheri me kujdes III (Akusheri) 0.002x5 x50	0.50
2.10	Udhëheqja e lindjes (Akusheri) 0.002x5 x100	1

<b>3.</b>	<b>Mentor dhe anetar për mbrojtjen e temës në ciklin e parë Tema 134 x 0.2</b>	<b>26.80</b>
<b>4.</b>	<b>Përgatitja e lëndëve të reja-ligjërata</b>	<b>10.00</b>
4.1	Gjinekologji I (Mjekësi e përgjithshme)	1.00
4.2	Gjinekologji II (Mjekësi e përgjithshme)	1.00
4.3	Gjinekologji (Stomatologji)	1.00
4.4	Gjinekologji me akusheri me kujdes (Infermieri)	1.00
4.5	Gjinekologji me kujdes (Akusheri)	1.00
4.6	Gjinekologji(Praktika)	1.00
4.7	Akusheri me kujdes I (Akusheri)	1.00
4.8	Akusheri me kujdes II (Akusheri)	1.00
4.9	Akusheri me kujdes III (Akusheri)	1.00
4.10	Udhëheqja e lindjes (Akusheri)	1.00
<b>5.</b>	<b>Skripte interne nga ligjëratat</b>	<b>40.00</b>
	10 lëndë x 4	40.00
<b>GJITHSEJ NGA VEPRIMTARIA MËSIMORE ARSIMORE</b>		<b>176.80</b>

## VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE

<b>Nr. Rend</b>	<b>EMËRTIMI I VEPRIMTARISË</b>	<b>Pikë</b>
<b>1.</b>	<b>Punimi me rezultate shkencore origjinale, i botuar në revistën shkencore në të cilën punimet që botohen i nënshtrohen recensionit dhe që është e indeksuar të paktën në një bazë elektronike të revistave me punime që mund të gjenden në internet, siç janë: Ebsco, Emerald, Scopus, Web of Science, Journal Citation Report, SCImago Journal Rank ose në ndonjë bazë tjetër të revistave që do ta përcaktojë Këshilli kombëtar i arsimit universitar.</b>	<b>28.00</b>
1.1	<b><i>DEPRESIONI POSTPARTAL DHE MULTIPOLARITETI Florin Besimi et al. Medicus 2018, Vol.23 (3):244-247</i></b>	4.00
1.2	<b><i>INFEKSIONET GJENITALE DHE URINARE SI SHKAK I VIZITAVE TE SHPESHTA NE REPARTIN E GJINEKOLOGJISE Florin Besimi et al. Medicus 2019, Vol. 24 (3):350-3</i></b>	4.00
1.3	<b><i>TREATMENT CORRELATION OF SIDEROPENIC ANEMIA WITH IRON (III) PROTEIN SUCCINYLATE (IPS) AND SUCROMIAL IRON (SI) Florin Besimi et al. Acta Medica Balkanica. Vol. 4, issue 7-8, pg</i></b>	4.00

1.4	<b>133-13</b> <b>KORELACIONI I TRAJTIMIT TE ANEMISE SIDEROPENIKE ME HEKUR (III) PROTEIN SUCCINILATE DHE ME FEROSUCCROSOMAL</b> <i>Florin Besimi et al. Medicus 61, Vol. 23 (3) December 2018.</i>	4.00
1.5	<b>HOSPITAL BASED STUDY OF MATERNAL, PERINATAL AND NEONATAL OUTCOMES IN ADOLESCENT PREGNANCY COMPARED TO ADULT WOMEN PREGNANCY</b> <i>Florin Besimi et al. Open acces macedonian journal of medical sciences, Vol.7, issue 5, pg. 760</i>	4.00
1.6	<b>PRIMARY FALLOPIAN TUBE CARCINOMA: A CASE REPORT AND LITERATURE REVIEW</b> <i>Florin Besimi et al. Open acces macedonian journal of medical sciences, Vol. 5, issue 3, pg. 344.</i>	4.00
1.7	<b>GIANT FIBROEPITHELIAL POLYP OF VULVA: A CASE REPORT AND REVIEW OF LITERATURE</b> <i>Florin Besimi et al. Open acces macedonian journal of medical sciences, Vol. 39, issue 2-3, pg. 127-130</i>	4.00
2.	Pjesëmarrje në tubim shkencor profesional (prezantim gojor, poster) me abstrakt të botuar në përmbledhjen e konferencës – ndërkombëtare	4
2.1	<b>NDIKIMI I PCO SY NE AUTIZMIN</b> <i>Florin Besimi et al. Second international conference of faculty of medical sciences of Tetova. October 2017</i>	1.00
2.2	<b>BIRTH TRAUMA AS A RESULT OF A MODE DELIVERY</b> <i>Florin Besimi et al. Takim profesional mjekesore –Struge. Permbledhje abstraktesh. October 2017</i>	1.00
2.3	<b>DETETKTIMI I KARDIOPATIVE KONGJENITALE ME SKRININGUN AUSKULTATOR</b> <i>Florin Besimi et al. Suplement I kongresit te IV Kosovar per obstetrike dhe gjinekologji 2018.</i>	1.00
2.4	<b>PELVIC PRESENTATION OF THE FETUS AND WAY OF ENDING CHILD BIRTH</b> <i>Florin Besimi et al. Abstrakt konferenca e XXIII e shoqates se mjekeve shqiptar. Struge 2018.</i>	1.00
3.	Pjesëmarrje në takim shkencor/profesional me referat -prezantim oral 4 x 2 seksione	8
<b>GJITHSEJ VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE</b>		<b>40.00</b>



**VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE DHE VEPRIMTARI ME INTERES MË TË GJERË**

<b>Nr.</b>	<b>Emri i aktivitetit</b>	<b>Pikët</b>
<b>1.</b>	<b>Këshilli redaktues i revistës shkencore/profesionale ndërkombëtare</b>	<b>1.00</b>
1.1	<i>“Medicus”, botim i Shoqatës së Mjekëve Shqiptarë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.</i>	1.00
<b>2.</b>	<b>Anëtare e këshillit shkencor të konferencave ndërkombëtare</b>	<b>4.00</b>
2.1	<i>Konferenca e parë shkencore ndërkombëtare “Contemporary trends of medical sciences and the development dynamics of modern medicine”, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, UT, 3 - 4 Qershor 2016</i>	1.00
2.2	<i>Konferenca e dytë shkencore ndërkombëtare “Healthcare challenges of the 21st century”, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, UT, 13-14 Tetor 2017</i>	1.00
2.3	<i>Konferenca e tretë shkencore ndërkombëtare, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti i Tetovës, 8 - 10 Nëntor 2018</i>	1.00
2.4	<i>Konferenca e katërt shkencore ndërkombëtare, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti i Tetovës, 15 - 17 Maj 2019</i>	1.00
<b>3.</b>	<b>Pozitë udhëheqëse</b>	<b>9.00</b>
3.1	Drejtor i Spitalit klinik Tetove	6.00
3.2	Pjesëmarës i projekteve të Fondit për popullatë i Kombeve të Bashkuara, prej vitit 2018, në planifikimin dhe implementimin të aktiviteteve nga Programi e UNFPA 2016-2020	3.00
<b>4.</b>	<b>Konsulent i UNFPA</b>	<b>16.00</b>
4.1	Partneriteti i UNFPA me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë dhe Ministrinë e Shëndetësisë për uljen e vdekshmërisë amtare dhe neonatale (2018), bashkëpunim ky që vetëm brenda një vitit vdekshmërinë neonatale e uli më shumë se një të tretën. Dr. Besimi është marrë me projektimin dhe kryerjen e trajnimeve, për kujdesin efektiv perinatal, veçanërisht për pjesën që iu referua Spitalit klinik në Tetovë. Me këtë trajnim, ekipet multidisciplinore nga gjinekolog/obstetër, neonatolog dhe mami u trajnuan sipas protokoleve dhe standardeve të Organizatës Botërore Shëndetësore	2.00
4.2	Monitorimi i maternitetit për zbatimin e rekomandimeve dhe procedurave të prezantuara me trajnimin për kujdes efektiv perinatal, me qëllim promovimin e shëndetit të nënës dhe të porsalindurit (2019).	2.00
4.3	Kontribut në nismën për vlerësim të shpejtë të materniteteve për nevojat e mbrojtjes personale pajisje, si pasoj nga KOVID-19 (2020).	2.00

4.4	Anëtar i delegacionit kombëtar të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Punëtorinë e vendeve nga Ballkani për përmirësimin e cilësisë së shëndetit të nënës dhe të porsalindurve bazuar në zbatimin e rekomandimeve që dalin nga rishikimi i komplikimeve të rënda nga shëndeti i nënës, mbajtur në Bukuresht, Rumani, 28-29 nëntor 2018.	2.00
4.5	Hartimi i një broshure për të rritur ndërgjegjshmërinë e grave dhe familjeve të tyre për shenjat e rrezikut gjatë shtatzënisë dhe lindjes, (2018).	2.00
4.6	Krijimi dhe futja e një sistemi kombëtar për mbikëqyrjen dhe reagimin në obstetrikë, si pjesë iniciuar nga vendet e Ballkanit Perëndimor, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për shëndetin e nënës (2019-2020).	2.00
4.7	Kontributi në standardet e gjinekologjisë dhe obstetrikës për kushtet spitalore dhe ambulatore mbrenda aktiviteteve të Agjencisë për Cilësi dhe Akreditim të Institucioneve Shëndetësore (2018).	2.00
4.8	Anëtar i Trupit Koordinues të Projektit të Përbashkët të OKB-së "Shërbime shëndetësore të Sigurta dhe Inovative" ndërmjet tre agjencive të OKB-së, UNFPA, UNICEF dhe OBSH. Kontribut të veçantë Doc. Dr. Besimi dha për caktimin e shërbimeve mobile për gjinekologji dhe obstetrikë me qëllim përmirësimin dhe parandalimin e kancerit të qafës së mitrës në kushtet e pandemisë KOVID, me fokus të veçantë në gratë dhe vajzat në më të çënuara.	2.00
<b>5.</b>	<b>Primarius</b>	<b>2.00</b>
<b>GJITHSEJTË NGA VEPRIMTARIA ME INTERES TË GJËRË</b>		<b>32.00</b>

<b>REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR TU ZGJEDHUR NË TIUTLL</b>	<b>PIKË</b>
<b>VEPRIMTARIA MËSIMORE ARSIMORE</b>	<b>176.80</b>
<b>VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE-</b>	<b>40.00</b>
<b>VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE DHE NGA VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJËRË</b>	<b>32.00</b>
<b>GJITHSEJ</b>	<b>248.80</b>

07.02.2022, Tetovë

## KOMISIONI I RECENSENTËVE

1. **Prof. Dr.Sadi Bexheti (kryetar)** - profesor ordinar në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Tetovës

---

2. **Prof. Dr. Goran Dimitrov (anëtar)** - profesor inordinar në Fakultetin e Shkencave Mjekësisë, Universiteti "Shen Kirili dhe Metodij", Shkup

---

3. **Prof. Dr. Gligor Tofoski (anëtar)** - profesor inordinar në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti "Shën Kirili dhe Metodij", Shkup

---

Deri te:

KËSHILLI MËSIMOR-SHKENCOR I  
FAKULTETIT TË SHKENCAVE  
MJEKËSORE  
UNIVERSITETI I TETOVËS

## R E F E R A T

PËR ZGJEDHJEN E DY ASISTENTËVE NË LËMIN E ANATOMISË  
PATOLOGJIKE NË FAKULTETIN E SHKENCAVE MJEKËSORE NË  
UNIVERSITETIN E TETOVËS

Me vendim të Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit të Shkencave Mjekësore të Universitetit të Tetovës me nr. **22-188/1** dhe në bazë të konkursit të shpallur më 25.12.2021 në gazetën ditore “Koha” dhe “Sloboden Peçat”, është caktuar komisioni recensues për zgjedhje të dy asistentëve për lëndën mësimore **anatomia patologjike**, në përbërje me:

1. **prof. Dr. Suzana Manxhuka Kerliu** dhe - profesoresh e Anatomisë patologjike në Universitetin e Prishtinës, Dekanë në Fakultetin të Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës.
2. **prof. Dr.Slavica Kostadinova Kunovska** - profesoreshë e Anatomisë patologjike në Institutin e patologjisë në Shkup.
3. **prof. Dr. Sadi Bexheti**– profesor i rregullt në lëndën e anatomisë në Universitetin e Tetovës, Tetovë.

Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, si dhe duke vlerësuar zhvillimin e përgjithshëm profesional, shkencor dhe pedagogjik të kandidatëve dr. Learta Veliu dhe dr. Arifon Rakipi, komisioni recenzues ka për nder që të paraqesë raportin e mëposhtëm:

# R A P O R T

**Dr.Leartha Veliu**

## **TË DHËNA BIOGRAFIKE**

Dr. Leartha Veliu është e lindur në Gostivar në vitin 1990. Shkollimin fillor dhe të mesëm e ka kryer me sukses të vazhdueshëm të shkëlqyeshëm në Gostivar dhe duke marrë pjesë aktive në garat lokale nga fusha e matematikës, biologjisë dhe kimisë.

Në vitin 2008 regjistrohet si gjeneratë e parë e studentëve të mjekësisë së përgjithshme në Fakultetin e Shkencave Mjekësore pranë Universitetit Shtetëror të Tetovës të cilin e kreu në afatin e paraparë në vitin 2014 dhe ishte studentia e parë e diplomuar e kësaj gjenerate, me notë mesatare 9.74.

Nota mesatare e lëndës Patologji 1 dhe 2 gjatë studimeve është 10.

Gjatë kohës si studente u angazhua edhe në aktivitete ekstrakurrikulare me grupin shkencor por edhe me disa organizata joqeveritare, si nëpër aktivitete për shënimin e ditëve botërore të shëndetësisë si dhe pjesëmarrje nëpër konferenca të ndryshme mjekësore.

Si rezultat i suksesit në studime, disa vite radhazi i është dhënë bursë meritore nga ana e Universitetit të Tetovës, si dhe në vitin 2011 zgjidhet si studente e parë e dalluar e Fakultetit të Shkencave Mjekësore pranë Universitetit Shtetëror të Tetovës nga Forumi Rinor Islam me rastin e manifestimit të vitit të ri Hixhri 1433.

Më 24.12.2014 i është dhënë mirënjohje nga asociacioni nacional i qytetarëve prestigjioz akademik (NAPAG) për pjesëmarrje dhe arritjet akademike.

Gjatë vitit të fundit të studimeve (2013/2014) ka punuar në mënyrë vullnetare në repartin e patologjisë pranë Spitalit Klinik në Tetovë nën udhëheqjen e Prof.dr. Agim Ramadani.

Pas përfundimit të praktikës mjekësore, me sukses e ka dhënë provimin profesional më maj 2015 dhe morri licencë për punë si mjeke.

Nga muaji mars 2015 deri shtator 2015 ka qenë e angazhuar në Spitalin Klinik të Tetovës, si mjeke me kontratë në vepër.

Specializimin e patologjisë e ka filluar privat në shtator të vitit 2015 në Institutin e patologjisë pranë Universitetit Shën Kirili dhe Metodi.

Nga muaji korrik të vitit 2016 dhe në vijim është e punësuar në Spitalin 8 Shtatori si mjeke ne specializim në fushën e patologjisë.

Në vitin akademik 2020/2021 i ka filluar studimet e ciklit të tretë në mjekësin bazike në Universitetin Shën Kirili dhe Metodi.

Zotëron disa gjuhë të huaja si: anglisht (niveli lartë), maqedonisht (niveli lartë), gjermane (niveli bazik), dhe spanjolle (niveli bazik).

## **VEPRIMTARI MËSIMORE EDUKATIVE**

Pas kryerjes së studimeve nga viti 2014, është kyçur në mënyrë aktive në mësimin praktik të studentëve në lëndët Biologji qelizore, Gjenetikë humane, Patologji I dhe Patologji II në programet studimore Mjekësi e përgjithshme, Stomatologji, Infermieri, Akusheri dhe Fizioterapi në Universitetin e Tetovës.

## **VEPRIMTARI PROFESIONALE SHËNDETËSORE**

Dr. Learta Veliu, gjatë specializimit është e kyçur në mënyrë aktive në veprimtari shëndetsore ne Institutin e Patologjisë, respektivisht në procedurat diagnostike dhe procedurat e autopsionit në të gjitha fushat e patologjisë. Është anëtare e “North Macedonia Division of IAP” si dhe e Organizatës së patologëve në Maqedoninë e Veriut ku në mënyrë aktive është e pranishme në seksionet patologjike dhe edukative si dhe seminare të organizuar nga kjo Shoqatë.

## **TRAJNIME**

- Në korrik të vitit 2009 ka realizuar qëndrim njëmuor në Institutin e anatomisë në Fakultetin e mjekësis në Grac të Austrisë (Wet Specimen Dissection Lab Course).
- Në korrik të vitit 2011 ka realizuar qëndrim njëmuorë në Wels të Austrisë në repartin e Traumatologjisë dhe ortopedisë (Klinikum Wels – Grieskirchen).
- Në shtator të vitit 2013 ka realizuar qëndrim njëmuor në Fakultetin e mjekësisë në Edirne të Turqisë.

- Në janar 2015 ka realizuar qëndrim njëmuajor në repartin e kardiokirurgjisë në Zurich-Zvicër (Heart Center Triemli : Department of Cardial surgery).

## PUNIME PËR RECENZION

Për zgjedhje në thirrjen asistent doktorand kandidatia i bashkangjet punimet e mëposhtme:

1. Osseous Metaplasia in Ovarian Endometrial Cyst : A case report. **Leartha Veliu**, DafinaNikolova, VesnaJanevska, Biomedical – Journal of scientific and technical research 2574-1241

Metaplazioni kockor në traktin gjenital femëror është gjetje e rrallë me etiologji dhe rëndësi të panjohur klinike. Paraqesim një rast të rrallë të metaplazionit kockor në cistën endometroide në vezore si dhe lidhshmërinë e mundshme me inflamacionin kronik.

